



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07
Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Për: **Trupin Gjykses II**
Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës
Gjykatës Kristof Barte
Gjykatës Ginel Metro
Gjykatës Fergal Gejnor, Gjykatës rezervë

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 3 dhjetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesat e Prokurorisë lidhur me Dëshmitarë të Propozuar të Mbrojtjes

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith
Valeria Boliçi
Methju Halling
Xhejms Paç

Mbrojtjes së Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris
Hju Bauden
Elinor Stivenson

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt

Tobi Kadman
Karl Bakli
Xhonatan Piter Uorbojs

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	PARASHTRIME.....	7
III.	DISPOZITAT LIGJORE TË ZBATUESHME	9
IV.	DISKUTIM	10
A.	Koha e vendimit	10
B.	Standardet ligjore për pranueshmërinë e dëshmime të propozuara	11
1.	Lidhja e dëshmisë së propozuar me çështjen gjyqësore	11
2.	Natyra e përsëritur e dëshmisë së propozuar	14
3.	Interesi publik dhe dëshmitë e propozuara	15
(a)	Parashtrimet e palëve	15
(b)	Përkufizimi i “interesit publik”	18
(c)	Konstatimet paraprake të Trupit Gjyqësor lidhur me “interesin publik”	20
4.	Pranueshmëria e dëshmime të ekspertëve	23
C.	Dëshmitë e propozuara të dëshmitarëve DW1241, 1242, 1246, 1250 dhe 1251	25
1.	Dëshmitarët DW1246, 1250 dhe 1251	25
(a)	Parashtrimet e palëve	26
(b)	Konstatimet e Trupit Gjyqësor	28
2.	Dëshmitarët DW1241 dhe DW1242.....	31
(c)	Parashtrimet e palëve	31
(d)	Konstatimet e Trupit Gjyqësor	32
D.	Dëshmitë e e propozuara të ekspertëve DW1252 dhe DW1253	33
3.	Dëshmitarja DW1252 (znj. Majers)	34
(e)	Parashtrimet e palëve	34
(f)	Konstatimet e Trupit Gjyqësor	34
4.	Dëshmitari DW1253.....	37
(g)	Parashtrimet e palëve	37
(h)	Konstatimet e Trupit Gjyqësor	40
E.	Dëshmitë e propozuara të dëshmitarëve DW1243, DW1244, DW1245, DW1247, DW1248 dhe DW1254	42
5.	Parashtrimet e palëve	42
2.	Konstatimet e Trupit Gjyqësor	43
V.	LEJE PËR APELIM.....	45
VI.	KLASIFIKIMI	46
VII.	VENDIM	47

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në përputhje me nenet 21(4)(f) dhe 40(2) 40 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 116(1), 119, 127(1), 138(1) dhe 149 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), jep arsyet e plota me shkrim për vendimin e dhënë gojarisht në konferencën përgatitore për Mbrojtjen më 2 dhjetor 2021.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 korrik 2021, Mbrojtja e Hysni Gucatit dhe Mbrojtja e Nasim Haradinajt (përkatësisht "Mbrojtja e Gucatit" dhe "Mbrojtja e Haradinajt") dorëzuan dosjet e tyre paraprake.¹ Siç parashikohet në rregullën 95(5)(c) të Rregullores, Mbrojtjet e dy të akuzuarve i bashkëlidhën dosjeve paraprake listat e dëshmitarëve të mundshëm që do të thërrisnin në gjykim ("Lista e Paraprake e Dëshmitarëve të Gucatit", "Lista e Paraprake e Dëshmitarëve të Haradinajt" dhe bashkërisht "listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes").² Në to, për çdo dëshmitar të propozuar, Mbrojtja dha përshkrime të përgjithshme se me cilin aspekt përkatës/aspekte përkatëse lidhej dëshmia e secilit dëshmitar.

2. Më 21 korrik 2021, Trupi Gjykues e urdhëroi Mbrojtjen të dorëzonte një përmbledhje të fakteve dhe rrethanave lidhur me të cilat do të jepte dëshmi secili prej dëshmitarëve në listat paraprake të dëshmitarëve, në veçanti lidhur me faktet dhe

¹ F00258, Mbrojtja e Gucatit, *Dosja Paraprake e Mbrojtjes së Hysni Gucatit* ("Dosja Paraprake e Gucatit"), F00260, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrim i Dosjes së Ndërmjetme Paraprake të Mbrojtjes së Nasim Haradinajt*, ("Dosja Paraprake e Haradinajt"), 12 korrik 2021.

² F00258/A01, *Shtojcë 1 e Dosjes Paraprake të Mbrojtjes së Hysni Gucatit: Lista e Dëshmitarëve të Mundshëm që Synon të Thërrasë Mbrojtja (Pa paragjykuar ndryshimin dhe dorëzimin e mëvonshëm të saj për protokollim)* ("Lista Paraprake e Dëshmitarëve të Gucatit"); F00260/A01, *Shtojca 1 e Dosjes Paraprake të Mbrojtjes së Haradinajt: Lista e Dëshmitarëve të Mundshëm që Synon të Thërrasë Mbrojtja (Pa paragjykuar ndryshimin dhe dorëzimin e mëvonshëm të saj për protokollim)* ("Lista Paraprake e Dëshmitarëve të Haradinajt"), 12 korrik 2021; (bashkërisht "listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes"). Më 2 shtator 2021, gjatë konferencës përgatitore për gjykim, Mbrojtjet e dy të akuzuarve thanë se mund të kërkonin gjithashtu të thërrisnin të akuzuarit si dëshmitarë. Shih, në veçanti, Transkripti, 2 shtator 2021, f. 536, rreshtat 16-19, f. 539, rreshtat 24-25, f. 540, rreshtat 1-2.

rrethanat konkrete që thuhej se lidheshin me aspektin e identifikuar nga Mbrojtja si “interes publik” (“Urdhri i 21 Korrikut”).³

3. Më 27 gusht 2021, në pajtim me Urdhrin e 21 Korrikut, Mbrojtja bëri parashtrime shtesë për lidhjen e pretenduar të dëshmitarëve të propozuar (bashkërisht “parashtrimet paraprake të Mbrojtjes lidhur me dëshmitarët”).⁴ Mbrojtja e Haradinajt nuk bëri parashtrime lidhur me dëshmitarin 21, të propozuar në Listën Paraprake të Dëshmitarëve të Haradinajt.

4. Më 1 shtator 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) bëri të ditur se synonte të parashtronte një kërkesë për të hequr dëshmitarë të Mbrojtjes dhe pjesë të dëshmimeve të dëshmitarëve të Mbrojtjes që sipas saj nuk kishin lidhje me gjykimin.⁵

5. Më 2 shtator 2021, Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në të dorëzonte kërkesën e saj për heqjen e dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe të pjesëve të dëshmimeve të tyre deri më 15 shtator 2021 (“Urdhri i 2 Shtatorit”).⁶

6. Më 15 shtator 2021, ZPS-ja dorëzoi kërkesat e saj konfidenciale lidhur me dëshmitarët e Mbrojtjes (“Kërkesa për Heqje nga Lista”).⁷

7. Më 27 shtator 2021, në përputhje me Urdhrin e 2 Shtatorit, ekipet e Mbrojtjes iu përgjigjën Kërkesës për Heqje nga Lista (bashkërisht “Përgjigjet”).⁸

³ F00266, Trupi Gjykses, *Urdhër për Parashtrime dhe për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencës Përgatitore për Gjykim* (“Urdhri i 21 Korrikut”), 21 korrik 2021, para. 12.

⁴ F00288/A01, Mbrojtja e Gucatit, *Shtojca 1 e Parashtrimeve me Shkrim për Mbajtjen e Konferencës Përgatitore për Gjykim dhe Çështje lidhur me To* (“Parashtrime Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Gucatit”), 27 gusht 2021, konfidenciale; F00289, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrim lidhur me Dëshmitarët* (“Parashtrime Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Haradinajt”), 27 gusht 2021, konfidenciale.

⁵ Transkripti, 1 shtator 2021, f. 446, rreshtat 11-14.

⁶ Transkripti, 2 shtator 2021, f. 603, rreshtat 6-8 (“Urdhri i 2 Shtatorit”).

⁷ F00312, Prokurori i Specializuar, *Kërkesa të Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes* (“Kërkesa për Heqje nga Lista”), 15 shtator 2021, konfidenciale.

⁸ F00329, Mbrojtja e Gucatit, *Përgjigje ndaj Kërkesave të Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes* (“Përgjigja e Gucatit”), 27 shtator 2021; F00330, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesave të Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarë të Mbrojtjes* (“Përgjigja e Haradinajt”), 27 shtator 2021.

8. Më 30 shtator 2021, Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi një kërkesë ku kërkonte zgjatjen me dy javë të afatit të dorëzimit të aktekspertizës së dëshmitares 17, Ana Majers (“znj. Majers”),⁹ me të cilën u bashkua edhe Mbrojtja e Gucatit.¹⁰ Të njëjtën ditë, Trupi Gjykses urdhëroi Mbrojtjen e Haradinajt të dorëzonte aktekspertizën e znj. Majers deri më 15 tetor 2021 dhe ZPS-në që të dorëzonte njoftimin lidhur me të brenda shtatë ditëve nga nxjerrja e aktekspertizës (“Urdhri i 30 Shtatorit”).¹¹

9. Më 15 tetor 2021, Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi aktekspertizën e znj. Majers (“Aktekspertiza e Majersit”) në përputhje me rregullën 149(1) të Rregullores dhe urdhrat e 2 dhe 30 Shtatorit.¹²

10. Më 18 tetor 2021, Trupi Gjykses i informoi palët se vendimi për kërkesat në shqyrtim lidhur me dëshmitarët e propozuar të Mbrojtjes do të jepej pas konferencës përgatitore për Mbrojtjen dhe pas marrjes së parashtrimeve të Mbrojtjes në përputhje me rregullën 119(2) të Rregullores, nëse Mbrojtja do të vendoste të paraqiste prova.¹³

11. Më 20 tetor 2021, Mbrojtja e Haradinajt nxori udhëzimet që i kishte dhënë znj. Majers për qëllimin e përgatitjes së Aktekspertizës së Majersit.¹⁴

⁹ F00339, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin e Provave të Ekspertit*, 30 shtator 2021.

¹⁰ F00340, Mbrojtja e Gucatit, *Mocion për Bashkim me Kërkesën për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin e Provave të Ekspertit KSC-BC-2020-07-F00339*, 30 shtator 2021.

¹¹ F00343, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin e Provave të Ekspertit (“Urdhri i 30 Shtatorit”)*, 30 shtator 2021.

¹² F00376, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrim i Aktekspertizës nga Mbrojtja e z. Haradinaj*, 15 tetor 2021; F00376/A01, Mbrojtja e Haradinajt, *Shtojca 1: Aktekspertiza e znj. Ana Majers lidhur me Rrjetin Ndërkombëtar të Sinjalizuesve (“Aktekspertiza e Majersit”)*, 15 tetor 2021. *Shih gjithashtu Urdhrin e 2 Shtatorit; Urdhrin e 30 Shtatorit.*

¹³ Transkripti, 18 tetor 2021, f. 817.

¹⁴ F00386, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrim i Udhëzimeve të Mbrojtjes për Dëshmitarin Ekspert 17 me Shtojcën Konfidenciale 1*, 20 tetor 2021; F00386/A01, Mbrojtja e Haradinajt, *Shtojca 1 Parashtrimet e Mbrojtjes mbi udhëzimet për dëshmitarin ekspert 17*, 20 tetor 2021, konfidenciale; Urdhri i 2 Shtatorit; Urdhri i Shtatorit.

12. Më 22 tetor 2021, ZPS-ja dorëzoi kundërshtimin e saj ndaj aktekspertizës së Majersit në përputhje me rregullën 149(2)(a) të Rregullores ("Kundërshtimi për Majersin").¹⁵

13. Më 23 tetor 2021, Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi një kërkesë për të shtuar një ekspert tjetër në Listën e Paraprake të Dëshmitarëve të Haradinajt ("dëshmitari i dytë ekspert").¹⁶

14. Më 26 tetor 2021, Trupi Gjykses urdhëroi Mbrojtjen e Haradinajt të dorëzonte aktekspertizën e dëshmitarit të dytë ekspert deri më 9 nëntor 2021 dhe urdhëroi ZPS-në të dorëzonte çfarëdo njoftimi lidhur me të brenda shtatë ditësh nga njoftimi i aktekspertizës.¹⁷

15. Më 1 nëntor 2021, Mbrojtja e Haradinajt iu përgjigj Kundërshtimit për Majersin.¹⁸

16. Më 9 nëntor 2021, Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi aktekspertizën e dëshmitarit të dytë ekspert ("Aktekspertiza e Dëshmitarit të Dytë Ekspert").¹⁹

17. Të njëjtën ditë, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër për caktimin e datës, në të cilin, *ndër të tjera*, caktoi datën e konferencës përgatitore për Mbrojtjen dhe përsëriti se kërkesat në shqyrtim lidhur me dëshmitarët e propozuar të Mbrojtjes do të

¹⁵ F00388, Prokurori i Specializuar, *Kundërshtim i Prokurorisë ndaj Ekspertit dhe Aktekspertizës së Propozuar nga Mbrojtja* ("Kundërshtimi për Majersin"), 22 tetor 2021.

¹⁶ F00394, Kërkesë e Haradinajt, *Kërkesë e Mbrojtjes për Shtimin e një Eksperti në Listën e Dëshmitarëve të Mundshëm* ("Kërkesa e Haradinajt për Dëshmitar Ekspert Shtesë"), 23 tetor 2021, konfidenciale. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e Haradinajt i referohet këtij dëshmitari me numrin 18, ndërsa në listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe në Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes është shënuar një tjetër individ me këtë numër.

¹⁷ Transkripti, 26 tetor 2021, f. 1412 rreshti 21 deri në f. 1413 rreshti 8.

¹⁸ F00410, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kundërshtimit të Prokurorisë ndaj Ekspertit dhe Aktekspertizës së Propozuar nga Mbrojtja* ("Përgjigjja ndaj Kundërshtimit për Majersin"), 1 nëntor 2021, konfidenciale. *Shih gjithashtu* F00410/RED.

¹⁹ F00426, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrim i Aktekspertizës nga Mbrojtja e z. Haradinajt*, 9 nëntor 2021; F00426/A01, Mbrojtja e Haradinajt, *Shtojca A e Parashtrimit të Aktekspertizës nga Mbrojtja e z. Haradinajt* ("Aktekspertiza e Dëshmitarit të Dytë Ekspert"), 9 nëntor 2021, konfidenciale. *Shih gjithashtu* Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1969 rreshti 18 deri në f. 1970 rreshti 9.

trajtoheshin në konferencën përgatitore për Mbrojtjen dhe vendimet lidhur me to do të jepeshin ose gojarisht ose me shkrim deri më 3 dhjetor 2021.²⁰

18. Më 16 nëntor 2021, ZPS-ja dorëzoi kundërshtimin e saj ndaj aktekspertizës së dëshmitarit të dytë ekspert ("Kundërshtimi për Dëshmitarin e Dytë Ekspert").²¹

19. Më 22 nëntor 2021, Mbrojtja e Haradinajt iu përgjigj Kundërshtimit për Dëshmitarin e Dytë Ekspert.²²

20. Më 26 nëntor 2021, Trupi Gjykses lëshoi vendimin mbi mocionet e Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave në përputhje me rregullën 130 të Rregullores.²³

21. Më 29 nëntor 2021, Mbrojtja dorëzoi listat e saj të dëshmitarëve dhe provave në përputhje me rregullën 119(2) të Rregullores dhe me Urdhrin e Trupit Gjykses ("parashtrimet sipas rregullës 119(2)").²⁴

22. Më 1 dhjetor 2021, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë shtesë lidhur me dëshmitarët e propozuar të Mbrojtjes dhe dëshmitë e propozuara të tyre ("Kërkesa Shtesë").²⁵

23. Më 2 dhjetor 2021, Trupi Gjykses mbajti konferencën përgatitore për Mbrojtjen gjatë së cilës, pasi dëgjoi palët, Trupi Gjykses përcaktoi numrin e dëshmitarëve që mund të thërrasë Mbrojtja, përcaktoi kohën në dispozicion të Mbrojtjes për paraqitjen

²⁰ F00428, Trupi Gjykses *Urdhër për Planin e Punës dhe Caktimin e Afateve për Hapat e Tjerë të Procesit* ("Urdhri i 9 Nëntorit"), 9 nëntor 2021, para. 14.

²¹ F00438, Prokurori i Specializuar, *Kundërshtim i Prokurorisë për Dëshmitarin Ekspert 18 dhe Aktekspertizën e Propozuar nga Mbrojtja* ("Kundërshtimi për Dëshmitarin e Dytë Ekspert"), 16 nëntor 2021, konfidencial.

²² F00444, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes së Haradinajt ndaj Parashtrimit F00438* ("Përgjigje ndaj Kundërshtimit për Dëshmitarin e Dytë Ekspert"), 22 nëntor 2021, konfidenciale.

²³ F00450, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionet për Rrëzimin e Akuzave*, 26 nëntor 2021.

²⁴ F00460, Mbrojtja e Gucatit, *Parashtrim nga Mbrojtja i Listës së Dëshmitarëve të Pritshëm, me Shtojcën 1* ("Lista e Dëshmitarëve të Propozuar të Gucatit") dhe Shtojcën 2 ("Lista e Provave Materiale të Propozuara të Gucatit"), 29 nëntor 2021; F00461, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrim i Mbrojtjes sipas Rregullës 119 në Emër të Nasim Haradinajt me Shtojcën 1* ("Lista e Dëshmitarëve të Propozuar të Haradinajt") dhe Shtojcën 2 ("Deklaratat e Propozuara të Dëshmitarëve të Haradinajt"), 29 nëntor 2021, konfidenciale. *Shih gjithashtu*, Urdhri i 9 Nëntorit, para. 17(a).

²⁵ F00466, Prokurori i Specializuar, *Kërkesa të Mëtejshme të Prokurorisë lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes* ("Kërkesa Shtesë"), 1 dhjetor 2021, konfidenciale.

e provave dhe dha udhëzime të mëtejshme të nevojshme për të siguruar gjykim të drejtë dhe të shpejtë. Trupi Gjykses lëshoi gjithashtu një urdhër gojor lidhur me kundërshtimet e përmendura më lart dhe informoi se arsyet me shkrim do të jepeshin më pas.²⁶

II. PARASHTRIME

24. Në Kërkesën për Heqje nga Lista, ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses të: (i) heqë pesë dëshmitarë nga listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes (“Kërkesa e parë”); dhe (ii) të mos autorizojë dëshmitë e pesë dëshmitarëve nga listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes, duke qenë se ato dëshmi nuk kanë të bëjnë me aspekte të lidhura me akuzat kundër të akuzuarve (“kërkesa e dytë”).²⁷

25. Në Kundërshtimin për Majersin, ZPS-ja kërkon mospranimin e Aktekspertizës së Majersit dhe që znj. Majers të mos autorizohet të dëshmojë.²⁸

26. Në Kundërshtimin për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, ZPS-ja kërkon që Trupi Gjykses të mos pranojë përfshirjen e aktekspertizës së ekspertit të dytë në prova dhe të mos autorizojë dhënien e dëshmisë nga dëshmitari i dytë.²⁹

27. Në Kërkesën Shtesë, ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses të heqë një prej dëshmitarëve të propozuar të Gucatit dhe të mos autorizojë prova të papërshtatshme në formën e opinioneve që nuk kanë lidhje me akuzat kundër të akuzuarve, që përmbajnë pesë prej deklaratave të propozuara të dëshmitarëve.³⁰

²⁶ Urdhër gojor mbi Përmbledhjen e Vendimit të Trupit Gjykses lidhur me Mocionet e ZPS-së për Heqjen nga Lista të Dëshmitarëve të Mbrojtjes, versioni jopërfundimtar i transkriptit, 2 dhjetor 2021, f. 2105-2107.

²⁷ Kërkesa për Heqje nga Lista, para. 1.

²⁸ F00388, Prokurori i Specializuar, *Kundërshtim i Prokurorisë ndaj Ekspertit dhe Aktekspertizës së Propozuar nga Mbrojtja* (“Kundërshtimi për Majersin”), 22 tetor 2021.

²⁹ F00438, Prokurori i Specializuar, *Kundërshtim i Prokurorisë për Dëshmitarin Ekspert 18 dhe Aktekspertizën e Propozuar nga Mbrojtja* (“Kundërshtimi për Dëshmitarin e Dytë Ekspert”), 16 nëntor 2021, konfidencial.

³⁰ Kërkesa Shtesë, para. 1.

28. Mbrojtja i kundërshton të gjitha kërkesat dhe kundërshtimet e lartpërmendura.³¹

29. Lidhur me Kërkesën për Heqje nga Lista, Mbrojtja e Gucatit përgjigjet se ky mocion është i parakohshëm duke vërejtur, *ndër të tjera*, se në kohën e parashtrimit të tij, paraqitja e provave nga ZPS-ja nuk kishte përfunduar ende dhe se Mbrojtjes i duhej ende të vendoste nëse: (i) do të paraqiste prova; (ii) do të parashtronte listën e saj përfundimtare të dëshmitarëve; dhe (iii) do t'i jepte ZPS-së deklaratat e dëshmitarëve siç parashikohet në rregullën 119 të Rregullores.³² Mbrojtja e Gucatit gjithashtu parashtron se diskrecioni për të përjashtuar provat përkatëse sipas rregullës 138(1) të Rregullores nuk zbatohet për provat e Mbrojtjes.³³ Krahas pajtimit me qëndrimin e Mbrojtjes së Gucatit, Mbrojtja e Haradinajt parashtron se dëshmitarët e kundërshtuar faktikisht kanë lidhje me procesin aktual.³⁴

30. Lidhur me Kundërshtimin për Majersin, Mbrojtja e Haradinajt përgjigjet se mocioni duhet të rrëzohet si i pabazë.³⁵ Në lidhje me Kundërshtimin për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, Mbrojtja e Haradinajt përgjigjet se ai duhet të rrëzohet dhe dëshmia e ekspertit të dytë të propozuar duhet të pranohet pasi, siç parashtrohet prej saj, ajo lidhet me çështjen dhe do ta ndihmojë Trupin Gjykses në marrjen e vendimit.³⁶ Në lidhje me Kërkesën Shtesë, Mbrojtja e Gucatit e kundërshtoi mocionin në parashtrimet e saj me gojë gjatë konferencës përgatitore për Mbrojtjen.³⁷

³¹ Përgjigja e Gucatit; Përgjigja e Haradinajt; Përgjigja ndaj Kundërshtimit të Majersit; Përgjigje ndaj Kundërshtimit të Dëshmitarit të Dytë Ekspert; Versioni jopërfundimtar i transkriptit, 2 dhjetor 2021, f. 2071-2076.

³² Përgjigja e Gucatit, para. 19-25, 29, 57.

³³ Përgjigja e Gucatit, para. 16-18, 49-54.

³⁴ Përgjigja e Haradinajt, para. 3-11, 27-29, 42. *Shih gjithashtu* Versioni jopërfundimtar i transkriptit, 2 dhjetor 2021, f. 2073-2074.

³⁵ Përgjigja ndaj Kundërshtimit për Majersin, para. 3, 39.

³⁶ Përgjigje ndaj Kundërshtimit të dëshmitarit të dytë ekspert, para. 48-49.

³⁷ Versioni jopërfundimtar i transkriptit, 2 dhjetor 2021, f. 2071.

III. DISPOZITAT LIGJORE TË ZBATUESHME

31. Në përputhje me nenin 21(4)(f) të Ligjit, në përcaktimin e akuzave kundër të akuzuarit, i akuzuari gëzon të drejtën të marrë në pyetje, ose të ketë marrë në pyetje, dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij në kushte të njëjta me ato të dëshmitarëve kundër tij.

32. Në përputhje me nenin 40(2) të Ligjit dhe rregullës 116(1) të Rregullores, trupi gjykues mund të miratojë procedura dhe modalitete që janë të nevojshme për të mundësuar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procedurave, duke i respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarve.

33. Rregulla 119(1) dhe (2) e Rregullores parashikon se më së voni, në përfundimin e paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar, ose pas një vendimi sipas rregullës 130, nëse është marrë një vendim i tillë, Mbrojtja vendos nëse do të paraqesë prova dhe informon trupin gjykues në lidhje me këtë. Në rast se Mbrojtja vendos të paraqesë prova, trupi gjykues urdhëron paraqitjen, *ndër të tjera*, të listës së dëshmitarëve të cilët Mbrojtja synon të thërrasë, së bashku me një përmbledhje të fakteve në lidhje me të cilat pritet të dëshmojë secili dëshmitar. Mbrojtja duhet të përmendë konkretisht pretendimet në aktakuzë në lidhje me të cilat pritet të dëshmojë secili dëshmitar, duke përmendur konkretisht akuzat dhe paragrafët përkatës të aktakuzës.

34. Në pajtim me rregullën 119(3) të Rregullores, trupi gjykues mban një konferencë përgatitore për Mbrojtjen gjatë së cilës, pasi të ketë dëgjuar palët, trupi gjykues mund, *ndër të tjera*, të përcaktojë numrin e dëshmitarëve që mund të thërrasë Mbrojtja, të udhëzojë Mbrojtjen të heqë dëshmitarët përsëritës, dhe të japë çfarëdo udhëzimi shtesë të nevojshëm për garantimin e një gjykimi të drejtë e të shpejtë.

35. Në pajtim me rregullën 127(1) të Rregullores, palët kanë të drejtë të paraqesin prova që kanë lidhje me çështjen gjyqësore.

36. Në pajtim me rregullën 138(1) të Rregullores, provat pranohen vetëm në qoftë se kanë lidhje me lëndën, janë të vërteta, kanë vlerë provuese dhe vlera provuese e tyre nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.

37. Në pajtim me rregullën 149 të Rregullores, trupi gjykues mund të dëgjojë dëshmitë e dëshmitarëve ekspertë.

IV. DISKUTIM

A. KOHA E VENDIMIT

38. Trupi Gjykues po e jep tani këtë vendim përmbledhës mbi për kërkesat e lartpërmendura të ZPS-së për disa arsye. Së pari, Trupi Gjykues mbajti parasysh kërkesën e Mbrojtjes që të mos merrej vendim derisa ajo të jepte indikacion në përputhje me rregullën 119 të Rregullores nëse do të kërkonte të thërriste dëshmitarët objekt i Kërkesës për Heqje nga Lista. Lidhur me këtë, Trupi Gjykues vëren se, në pajtim me rregullën 95(5)(c) të Rregullores, Mbrojtja mund të dorëzojë “një listë të dëshmitarëve të mundshëm” dhe, nëse vendos të paraqesë prova, duhet të dorëzojë “listën e dëshmitarëve” në përputhje me rregullën 119(2). Për rrjedhojë, Mbrojtja mund të zgjedhë të heqë, në fazën e rregullës 119(2), dëshmitarë që i kishte në listën e dëshmitarëve të mundshëm sipas rregullës 95(5)(c). Në çështjen aktuale, Mbrojtja zgjodhi në fakt të hiqte në fazën e rregullës 119(2) disa dëshmitarë (që i kishte kundërshtuar ZPS-ja) nga listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes. Trupi Gjykues e konsideroi të përshtatshme të priste parashtrimet sipas rregullës 119(2) përpara se të shprehej për kërkesat e ZPS-së, për të marrë vendim për atë listë. Së dyti, Trupi Gjykues e konsideroi të përshtatshme t'i jepte Mbrojtjes një mundësi të drejtë dhe të plotë për të përshkruar natyrën dhe lidhjen e dëshmitarëve të propozuar në parashtrimet e tyre sipas Rregullës 119(2) me akuzat në Aktakuzë. Së treti, Trupi Gjykues ishte i vetëdijshëm se parashtrimet sipas rregullës 119(2) do të përmbanin argumente dhe përmbledhje shtesë që mund të ndihmonin Trupin Gjykues për

marrjen e vendimit lidhur me të gjithë dëshmitarët e kundërshtuar. Së fundi, me qëllim që vendimi i tij t'i shkaktonte sa më pak dëm përgatitjeve të Mbrojtjes, Trupi Gjykses ka vazhduar me shpejtësinë më të madhe për të dhënë këto arsye të plota me shkrim për vendimin që mori në konferencën përgatitore për Mbrojtjen.

B. STANDARDET LIGJORE PËR PRANUESHMËRINË E DËSHMIVE TË PROPOZUARA

39. Trupi Gjykses vëren që në fillim se vendimi se cilët dëshmitarë të thërriten përgjithësisht u takon palëve, me mundësinë që gjykatësit të thërrasin dëshmi shtesë.³⁸ Ndonëse duhet respektuar deri në njëfarë shkalle e drejta e palëve për të përzgjedhur dhe parashtruar provat e tyre, diskrecioni i tyre nuk është i pakufizuar dhe është objekt i dy cilësimeve të përgjithshme, që pjesërisht përkrijnë me njëri-tjetrin përkatësisht i: (i) lidhjes me çështjen të provave të propozuara;³⁹ dhe (ii) natyrës përsëritëse të provave të propozuara.⁴⁰

1. Lidhja e dëshmisë së propozuar me çështjen gjyqësore

40. Pala thirrëse duhet të vërtetojë dhe Trupi Gjykses duhet të verifikojë që provat e propozuara kanë lidhje me çështjen. Kjo vlen si për provat shkresore, ashtu edhe për dëshmitë gojore.⁴¹ Provat kanë lidhje me çështjen kur lidhen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me elementë të veprës(veprave) ose me format e përgjegjësive të paraqitura në aktakuzë ose me fakte ose rrethana të tjera materiale për argumentet dhe provat e palëve.⁴²

41. Detyrimi për të demonstruar me qartësi dhe konkretësi se provat e propozuara kanë lidhje dhe përshtaten me argumentet dhe provat e asaj pale, i takojnë palës

³⁸ Rregullat 132 dhe 127(2)(c) të Rregullores.

³⁹ Rregulla 127(1) e Rregullores.

⁴⁰ Rregulla 119(3) e Rregullores.

⁴¹ F00334, Trupi Gjykses, *Vendim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jogojore* ("Vendimi për Provat Materiale Jogojore"), 29 shtator 2021, para. 11.

⁴² Vendimi për Provat Materiale Jogojore, para. 11-12.

thirrëse.⁴³ Demonstrimi i lidhjes me çështjen kërkon më tepër se sa një lidhje të dobët ose të largët me faktet dhe rrethanat e një çështjeje.⁴⁴

42. Gjithashtu, kriteret për paraqitjen dhe pranimin e provave që zbatohen në këtë juridiksion e bëjnë të qartë se lidhja me çështjen është kusht themelor dhe i domosdoshëm që duhet të plotësohet nga çdo provë e propozuar nga një palë.⁴⁵ Për shembull, rregulla 95(5)(c) e Rregullores kërkon që Mbrojtja të saktësojë në dosjen e saj paraprake se me cilin aspekt përkatës konkret lidhen provat.⁴⁶ Rregulla 127(1) e Rregullores thotë se palët kanë të drejtë të paraqesin prova “që kanë lidhje me çështjen gjyqësore”.⁴⁷ I njëjti kriter për lidhjen me çështjen zbatohet gjithashtu, për shembull, për deklaratat e të akuzuari pa betim,⁴⁸ për thirrjen e një dëshmitari ekspert,⁴⁹ për

⁴³ Për ngjashmëri, ICTR, *Prosecutor v. Bagosora et al.*, ICTR-98-41-T, Trial Chamber, [Decision on Admission of Tab 19 of Binder Produced in Connection with Appearance of Witness Maxwell Nkole](#), 13 September 2004, paras. 7-8; ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-AR73.13, Appeals Chamber, [Decision on Jadranko Prlić's Consolidated Interlocutory Appeal Against the Trial Chamber's Orders of 6 and 9 October 2008 on Admission of Evidence](#), 12 January 2009, para. 17; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on the Prosecution's First Bar Table Motion](#), 13 April 2010, para. 6.

⁴⁴ Vendimi për Provat Materiale Jogojore, para. 12. *Shih gjithashtu* ICTY, *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-PT, [Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Srebrenica Intercepts with Confidential Annexes](#), 1 shtator 2008, para. 6.

⁴⁵ *Shih, në përgjithësi*, nenet 37(3)(a) dhe (5), 42(1) të Ligjit. *Shih gjithashtu, për ngjashmëri* ICTY/TPNJ, *Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve*, IT-05-87-PT, [Decision on Prosecution's Rule 92 bis Motion](#), 4 July 2006, para. 5.

⁴⁶ Rregulla 119(2) e Rregullores.

⁴⁷ Rregullat 137(1) dhe 138(1) të Rregullores.

⁴⁸ Rregulla 142(1) e Rregullores.

⁴⁹ Rregulla 149(2)(a) e Rregullores. *Shih për ngjashmëri* ICTY, *Prosecutor v. Milošević*, IT-98/29-1-T, Trial Chamber, [Decision on Defence Expert Witnesses](#), 21 August 2007, paras 6-10; *Prosecutor v. Milošević*, IT-98/29-1-T, Trial Chamber, [Decision on Admission of Expert Report of Robert Donia](#), 15 February 2007, para. 10; *Prosecutor v. Stanišić & Simatović*, IT-03-69-PT, Trial Chamber, [Decision on Prosecution's Submission of the Expert Report of Nina Tromp and Christian Nielsen Pursuant to Rule 94bis](#), 18 March 2008, paras 7, 11; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber, [Decision on the Admissibility of the Narratives of Expert Witness Richard Butler](#), 27 March 2008, para. 9; *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-T, Trial Chamber, [Decision on Expert Reports by Richard Butler](#), 4 March 2009, para. 8; *Prosecutor v. Mladic*, IT-09-92-T, Trial Chamber, [Decision on Defence Request to Disqualify Richard Butler as an Expert and bar the Prosecution from Introducing his Reports](#), 19 October 2012, para. 7. Për shembull, në çështjen gjyqësore kundër Slobodan Millosheviçit, aktekspertiza dhe dëshmia e pretenduar e një eksperti lidhur me historinë e konflikteve serbo-kroate u quajtën të papranueshme sepse nuk kishin lidhje me aspektet nën gjykim: *Prokurorja kundër Millosheviçit*, IT-02-54-T, Trial Chamber, [Decision on Admissibility of Expert Report of Vasilije Krestić](#), 7 December 2005, para. 6.

pyetjen e dëshmitarit nga pala kundërshtare,⁵⁰ për mundësinë e detyrimit të një dëshmitari që të dëshmojë,⁵¹ për pranimin e provave me rëndësi për përcaktimin e dënimit,⁵² dhe në lidhje me pranimin e provave shitesë në apel.⁵³ Kriteri i lidhjes me çështjen zbatohet gjithashtu për propozimet për pranimin e provave me shkrim të çdo dëshmitari,⁵⁴ për konstatimin gjyqësor të një fakti të gjykuar,⁵⁵ për thirrjen e

⁵⁰ Rregulla 143(3) e Rregullores. *Për ngjashmëri ICTY, Prosecutor v. Krajišnik*, IT-00-39-T, [Decision on Cross Examination of Milorad Davidović](#), 15 December 2005, para. 8.

⁵¹ Neni 42(1) i Ligjit; rregulla 151(2)(b) e Rregullores.

⁵² Rregulla 162(1) e Rregullores.

⁵³ Rregulla 181(7) e Rregullores. *Shih gjithashtu, Për ngjashmëri ICTY, Prosecutor v. Galić*, IT-98-29-A, Appeals Chamber, [Decision on Defence Second Motion for Admission of Additional Evidence Pursuant to Rule 115](#), 21 March 2005, para. 14; *Prosecutor v. Kupreškić et al.*, IT-95-16-A, Appeals Chamber, [Decision on the Admission of Additional Evidence Following Hearing of 30 March 2001](#), 11 April 2001, para. 6.

⁵⁴ Neni 37(3)(a) i Ligjit; rregullat 154 dhe 155 të Rregullores. *Për ngjashmëri, ICTY/TPNJ, Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve*, IT-05-87-T, Dhoma Gjyqësore, [Decision on Prosecution Motion for Admission of Evidence Pursuant to Rule 92 quarter](#), 16 February 2007, paras 3, 6; *Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve*, IT-05-87-T, Dhoma Gjyqësore, [Decision on Prosecution Motion for Admission of Evidence Pursuant to Rule 92 quarter](#), 5 March 2007, para. 6; *Prokurori kundër Gjorgjeviçit*, IT-05-87/1-T, Dhoma Gjyqësore, [Decision on Prosecution's Motions for Admission of Evidence Pursuant to Rule 92 quarter](#), 5 February 2009, para. 5; *Prosecutor v. Tolimir*, IT-05-88/2-PT, Trial Chamber, [Decision on Prosecution's Motion for Admission of Evidence Pursuant to Rule 92 quarter](#), 25 November 2009, paras 27-28; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on Prosecution Motion for Admission of the Evidence of KDZ172 \(Milan Babić\) Pursuant to Rule 92 Quarter](#), 13 April 2010, para. 7; *Prosecutor v. Delić*, IT-04-83-PT, Trial Chamber, [Decision on Prosecution Motion for Admission of Evidence Pursuant to Rule 92 quarter](#), 9 July 2007, f. 4; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on Prosecution Motion for Admission of Testimony of Witness KDZ198 and Associated Exhibits Pursuant to Rule 92 quarter](#), 20 August 2009, para. 6.

⁵⁵ Rregulla 157 e Rregullores. *Për ngjashmëri ICTY, Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber, [Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Facts of Common Knowledge Pursuant to Rule 94\(A\)](#), 26 Shtator 2006, para. 11; *Prosecutor v. Stanišić & Župljanin*, IT-08-91-T, Trial Chamber, [Decision Granting in Part Prosecution's Motions for Judicial Notice of Adjudicated Facts Pursuant to Rule 94\(B\)](#), 1 April 2010, para. 29; *Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve*, IT-05-87-T, Dhoma Gjyqësore, [Decision on Prosecution Motion to Admit Documentary Evidence](#), 10 October 2006, paras 16, 18, 30; *Prosecutor v. Milošević*, IT-98-29/1-T, Trial Chamber, [Decision on Interlocutory Appeals Against Trial Chamber's Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts and Prosecution's Catalogue of Agreed Facts](#), 26 June 2007, para. 13; *Prosecutor v. Šešelj*, IT-03-67-T, Trial Chamber, [Decision on the Prosecution Motion to Take Judicial Notice of Facts Under Rule 94\(B\) of the Rules of Procedure and Evidence](#), 10 December 2007, para. 12.

dëshmitarëve nga përfaqësuesit e viktimave,⁵⁶ për pranimin e provave jोगojore,⁵⁷ dhe për lëshimin e urdhrave ose kërkesave për bashkëpunim në lidhje me mbledhjen e provave.⁵⁸ Kuadri ligjor dhe standardet e lartpërmendura zbatohen për çdo provë, pavarësisht nëse ajo paraqitet nga Prokuroria apo nga Mbrojtja.

43. Bazuar në sa më lart, sipas Rregullores, palët nuk janë të autorizuar të paraqesin prova që nuk kanë lidhje me çështjen. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses do të ushtrojë përgjegjësinë e vet për të siguruar që në dosjen e çështjes të paraqiten dhe dorëzohen vetëm prova të cilat me të vërtetë e përmbushin kriterin e lidhjes me çështjen.

2. Natyra e përsëritur e dëshmisë së propozuar

44. Në përputhje me rregullat 118(1)(a) dhe 119(3)(a) të Rregullores, Trupi Gjykses ka autoritetin të përcaktojë numrin e dëshmitarëve që një palë mund të thërrasë dhe ta udhëzojë atë palë të heqë dëshmitarët përsëritës.⁵⁹ Kjo përfshin kompetencën, *a fortiori*,

⁵⁶ Rregulla 114(5) e Rregullores. *Për ngjashmëri*, ICC, *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07, Trial Chamber II, [Decision on the Modalities of Victim Participation at Trial](#), 22 January 2010, para. 84; *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07, Appeals Chamber, [Judgement on the Appeal of Mr. Katanga against the Decision of Trial Chamber II of 22 January 2010 entitled Decision on the Modalities of Victim Participation at Trial](#), 16 July 2010, para. 114.

⁵⁷ Vendimi për Provat Materiale Jोगojore, para. 10-12. *Për ngjashmëri* ICC, *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07, Trial Chamber II, [Decision on the Prosecutor's Bar Table Motions](#), 17 December 2010, para. 16; *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07, Trial Chamber, [Decision on the Bar Table Motion of the Defence of Germain Katanga](#), 21 October 2011, para. 15; *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07, Trial Chamber II, [Directions for the Conduct of the Proceedings and Testimony](#), 20 November 2009, para. 100.

⁵⁸ Neni 37(5) i Ligjit; rregulla 111(6) e Rregullores. *Për ngjashmëri*, *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on Accused's Application for Binding Order \(French Republic\)](#), 30 June 2010; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, [Decision on Accused's Motion for Binding Order \(United Nations and NATO\)](#), 11 February 2011; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on the Accused's Second Motion for Binding Order \(The Islamic Republic of Iran\) and Motion for Subpoena to Interview General Director Sadeghi](#), 10 May 2011, para. 14; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on Accused's Motion for Binding Order \(The Kingdom of Saudi Arabia\)](#), 30 June 2011, paras 14, 18; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on Accused's Fifth Motion for Binding Order \(United States of America\)](#), 22 August 2012; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, [Decision on Accused's Second Motion for Subpoena to Interview President Bill Clinton](#), 21 August 2012, para. 12; *Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve*, IT-05-87-PT, Dhoma Gjyqësore, [Decision on Second Application of Dragoljub Ojdanic for Binding Orders Pursuant to Rule 54 bis](#), 17 November 2005, para. 18; *Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve*, IT-05-87-AR, [Decision on Request of United States of America for Review](#), 12 May 2006, para. 11.

⁵⁹ Rregullat 118(1)(a) dhe 119(3)(a) e Rregullores.

për të urdhëruar palën që të mos paraqesë prova që kanë lidhje me çështjen, por që kanë natyrë përsëritëse.

3. Interesi publik dhe dëshmitë e propozuara

(a) Parashtrimet e palëve

45. Si pjesë e argumenteve dhe provave të tyre, të dy të akuzuarit parashtrojnë se kanë vepruar në të mirë të "interesit publik".⁶⁰ Për të vërtetuar këtë pretendim, ata kërkojnë të thërrasin një numër dëshmitarësh në lidhje me këtë aspekt.⁶¹

46. Mbrojtja parashtron se sjellja që i atribuohet të akuzuarve përbënte ushtrim të ligjshëm të së drejtës së tyre themelore për lirinë e shprehjes, të garantuar nga Kushtetuta e Kosovës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ").⁶² Mbrojtja e Gucatit mbështetet gjithashtu në të drejtën kushtetuese të të akuzuarit për të pasur qasje në dokumentet e institucioneve publike dhe organeve të autoriteteve shtetërore⁶³ dhe parashtron se informimi i publikut për "bashkëpunimin" e ZPS-së me autoritetet serbe përfshihet në sferën e interesit publik, duke qenë se ai ngre shqetësime lidhur me pavarësinë dhe paanshmërinë e ZPS-së.⁶⁴ Mbrojtja e Haradinajt synon të paraqesë si "mbrojtje aktive" faktin se nxjerrjet e materialeve, nëse vërtetohen, janë të përligjura, sepse ato u bënë në interes të publikut dhe ishin të

⁶⁰ Dosja Paraprake e Gucatit, para. 72-73, 76, 140, 161, 184, 190, 222, 231, 237, 240, 256, 284, 297, 321, 334, 358; Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277 (d), 283-298.

⁶¹ Dosjet Paraprake të Mbrojtjes sugjerojnë se dëshmitarët e propozuar në vijim do të japin dëshmi (së paku pjesërisht) lidhur me atë çështje: *Shih* listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes, që u referohen dëshmitarëve 1 deri në 8, 10, 12 deri në 18. Disa prej këtyre dëshmitarëve janë hequr nga lista në parashtrimet sipas rregullës 119(2). *Shih më poshtë* para. **Error! Reference source not found., Error! Reference source not found..**

⁶² Dosja Paraprake e Gucatit, para. 21-22, që i referohet neneve 22, 40 të Kushtetutës së Kosovës, nenit 19 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokolleve të Saj, nenit 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("KEDNJ"); Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 213, 221, 234.

⁶³ Dosja Paraprake e Gucatit, para. 23, që u referohet neneve 41-42 të Kushtetutës së Kosovës dhe para. 188, 259-263, 279.

⁶⁴ *Shih për shembull* Dosja Paraprake e Gucatit, para. 72, 124, 140, 161, 184, 190, 222, 231, 237, 240, 256, 284, 297, 321, 334, 358.

nevojshme për të informuar publikun rreth polemikave të lidhura me Dhomat e Specializuara ("DHS"), duke mbrojtur kështu "interesin publik të publikut ndërkombëtar dhe atij kosovar".⁶⁵

47. Bazuar në këto parashtrime, është e qartë se Mbrojtja e Gucatit nuk po argumenton se "interesi publik" do të ofronte një "mbrojtje" në kuptimin e ngushtë, teknik,⁶⁶ ndërsa Mbrojtja e Haradinajt duket se e ngre një pretendim të tillë.⁶⁷ Mbrojtja e Gucatit duket se argumenton se fakti që të akuzuarit vepruan në të mirë të "interesit publik" do të ishte megjithatë i rëndësishëm për vlerësimin e ligjshmërisë së sjelljes së tyre kur shqyrtohet nga pikëpamja e ushtrimit të të drejtave të tyre themelore, në veçanti në lidhje me Pikat 5 dhe 6 të Aktakuzës.

48. Sa i takon faktit (fakteve) ose rrethanës (rrethanave) që thuhet se përbëjnë "interes publik" që ka lidhje me këtë proces gjyqësor, Mbrojtja duket se sugjeron se zbulimi i ekzistencës së bashkëpunimit ndërmjet, nga njëra anë, Republikës së Serbisë dhe, nga ana tjetër, Task Forcës Hetimore Speciale ("TFHS"), dhe/ose ZPS-në ishin "interesi publik" i lidhur me provat e tyre.⁶⁸ Mbrojtja e Gucatit parashtron më tej se ishte në "interesin publik" të bëhej e ditur se ZPS-ja (dhe/ose TFHS-ja) ka bashkëpunuar me zyrtarë të caktuar shtetërorë serbë (të cilët Mbrojtja e Gucatit më tej i përmend me emër në dosjen e saj paraprake) pasi, ajo pretendon se bashkëpunimi, "ngre pikëpyetje në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e ZPS-së".⁶⁹ Mbrojtja parashtron më tej se zbulimi i përfshirjes së disa zyrtarëve serbë në atë bashkëpunim ishte gjithashtu pjesë e "interesit publik" të pretenduar, sepse, sikurse sugjerohet, këta

⁶⁵ Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277(d), 296, *Shih gjithashtu* 283-298.

⁶⁶ *Shih* Transkripti, 1 shtator 2021, f. 466, rreshti 6.

⁶⁷ Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 277 (d); Transkript, 1 shtator 2021, f. 475.

⁶⁸ *Shih, në përgjithësi*, Dosja Paraprake e Gucatit, para. 72, 124, 140, 160-161, 184, 196, 222, 256, 284, 297, 321, 334, 358; Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 283-284. *Shih gjithashtu* Transkripti, 1 shtator 2021, f. 466, rreshtat 17-22, f. 470, rreshtat 23-25, f. 475, rreshtat 2-3.

⁶⁹ *Shih për shembull*, Dosja Paraprake e Gucatit, para. 72, 124, 140, 160-161, 184, 196, 222, 256, 284, 297, 321, 334, 358; Dosja Paraprake e Gucatit, para. 72, 124, 140, 160-161, 184, 196, 222, 256, 284. *Shih gjithashtu* Transkript, 1 shtator 2021, f. 473, rreshtat 2125, f. 474, rreshtat 1-7.

individë mendohet të jenë përgjegjës për krime të rënda në Kosovë.⁷⁰ Përveç kësaj, Mbrojtja e Haradinajt duket se sugjeron se nxjerrja publike e informacionit të kundërshtuar ishte gjithashtu e përligjur në të mirë të “interetit publik” për të vërtetuar anshmërinë etnike të pretenduar të Dhomave të Specializuara.⁷¹

49. ZPS-ja nuk pranon që “interesi publik” përbën mbrojtje ndaj akuzave dhe kundërshton që: (i) publikimi i bashkëpunimit ndërmjet Serbisë dhe TFHS-së/ZPS-së ishte në interesin publik ose, edhe nëse ishte, se (ii) ai do të justifikonte në ndonjë mënyrë sjelljen që i atribuohet të akuzuarve.⁷² Për më tepër, edhe nëse “interesi publik” do të konsiderohej si mbrojtje kundër akuzave materiale, ZPS-ja parashtron se dëshmitarët e kundërshtuar prapë nuk duhet të autorizohen të dëshmojnë sepse nuk ka asgjë që të tregojë se ata mund ta ndihmonin Trupin Gjykues në marrjen e vendimit mbi bazën e fakteve, ose se ata kanë ndonjë njohuri konkrete për bashkëpunimin e ZPS-së me autoritetet serbe.⁷³

50. Mbrojtja e Gucatit nuk bëri parashtrime në përgjigje të argumentit të ZPS-së në lidhje me interesin publik. Mbrojtja e Haradinajt argumenton se provat e propozuara të dëshmitarëve DW1250 dhe DW1251 janë drejtpërdrejt të lidhura me mbrojtjen e interesit publik të ngritur nga të akuzuarit. Mbrojtja e Haradinajt pohon se dëshmitarët e propozuar janë në gjendje të paraqesin prova për mbrojtjen e interesit publik, duke vënë në dukje se të dy, DW1250 dhe DW1251, cilësoheshin si sinjalizues dhe se, si rezultat, njohuritë e tyre të veçanta lidhen me mbrojtjen e të akuzuarve të interesit publik.⁷⁴

⁷⁰ Dosja Paraprake e Gucatit, para. 72-73, 75, 90-91.

⁷¹ Dosja Paraprake e Haradinajt, para. 283, 285.

⁷² Kërkesa për Heqje nga Lista, para. 13-14. Transkript, 1 shtator 2021, f. 459, rreshtat 20-22, f. 460, rreshtat 20-22.

⁷³ Kërkesa për Heqje nga Lista, para. 14.

⁷⁴ Përgjigja e Haradinajt, para. 33-35.

(b) Përkufizimi i “interesit publik”

51. Trupi Gjykses vëren se Ligji nuk përmban referencë apo përkufizim të nocionit “interes publik”. Rregullat 108(1)(c) dhe 153(1)(b)(iv) të Rregullores i referohen “interesit publik” lidhur me aspekte që nuk lidhen me diskutimin aktual.⁷⁵ Rregullorja nuk jep një përkufizim të “interesit publik”. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se Kushtetuta e Kosovës i referohet “interesit publik” në nenet 46 dhe 119, por lidhur me aspekte që nuk kanë vlerë për diskutimin aktual.

52. Megjithëse dispozitat e legjislacionit të Kosovës janë të zbatueshme si e drejtë materiale në DHS vetëm nëse janë të përfshira shprehimisht në Ligj, ka edhe instrumente të tjera normative të zbatueshme në Kosovë të cilat mund të zbatohen për qëllime të qartësimit ose interpretimit të kornizës ligjore të zbatueshme në këtë juridiksion. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses vëren se neni 200(4) i Kodit Penal të Kosovës (“KPK”) e përshkruan “interesin publik” (në kuadër të veprës penale “Zbulimi i paautorizuar i informacionit konfidencial”) si më poshtë: “‘Interes publik’ nënkupton që mirëqenia e përgjithshme e publikut mbipeshon interesin individual. Zbulimi i informacionit konfidencial është në interesin publik nëse ka të bëjë me planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e veprave penale kundër rendit kushtetues ose integritetit territorial të Republikës së Kosovës, ose vepra tjera penale që i shkaktojnë personit tjetër lëndim të rëndë trupor ose vdekjen”.⁷⁶

53. Trupi Gjykses thekson se Mbrojtja nuk e konteston rëndësinë e nenit 200(4) të KPK-së për kontekstin aktual.⁷⁷ Mbrojtja e Haradinajt gjithashtu paraqiti një numër instrumentesh shtesë që sipas saj kanë lidhje me këtë kontekst, pa përmendur ndonjë

⁷⁵ Shih rregullën 108(1)(c) dhe 153(1)(b)(iv) të Rregullores.

⁷⁶ Neni 200(4) i Kodit Penal të Kosovës.

⁷⁷ F00302, Mbrojtja e Gucatit, *Parashtrime me Shkrim në Pajtim me Urdhrin e Tretë Gojor të Dhënë më 2 Shtator 2021* (“Parashtrimet e Mbrojtjes së Gucatit në Pajtim me Urdhrin Gojor”), 6 shtator 2021, para. 9-10; F00301, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrime lidhur me Urdhrin e Tretë Gojor të Trupit Gjykses Dhënë në Seancën për Ecurinë e Çështjes* (“Parashtrimet e Mbrojtjes së Haradinajt në Pajtim me Urdhrin Gojor”), 6 shtator 2021, para. 34. Shih gjithashtu Transkripti, 1 shtator 2021, f. 469, rreshtat 9-12.

përkufizim tjetër të "interetit publik" që të ishte i ndryshëm apo të kishte përparësi mbi përkufizimin e përmendur më lart.⁷⁸

54. Trupi Gjykses vëren më tej se përkufizimi i "interetit publik" i përfshirë në nenin 200(4) të KPK-së në përgjithësi është në përputhje me përkufizimin e nocionit të "interetit publik" në të cilin mbështetet Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ("GJEDNJ") në lidhje me nenin 10 të KEDNJ-së, dhe në thelb nuk ndryshon prej tij. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, "interesi publik" zakonisht lidhet me çështje të cilat: (i) ndikojnë tek publiku në atë masë sa që ai mund të ketë interes legjitim mbi to; (ii) tërheqin vëmendjen e publikut ose e shqetësojnë atë në një shkallë të konsiderueshme, veçanërisht sepse ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve ose jetën e komunitetit; (iii) janë në gjendje të shkaktojnë polemika të konsiderueshme; (iv) kanë të bëjnë me një çështje të rëndësishme sociale; ose (v) përfshijnë një problem për të cilin publiku do të kishte interes të informohej.⁷⁹ Sipas GJEDNJ-së, një interes i tillë publik mund të ekzistojë, për shembull, në lidhje me proceset penale në përgjithësi,⁸⁰ krime të kryera,⁸¹ dhe me administrimin e drejtësisë.⁸² GJEDNJ-ja gjithashtu e ka bërë

⁷⁸ Transkripti, 1 shtator 2021, f. 469, rreshtat 13-17. *Shih gjithashtu F00300, Listë e Legjislacionit në lidhje me Sinjalizuesit sipas Urdhrit të Tretë Gojor të Trupit Gjykses II*, 6 shtator 2021.

⁷⁹ ECtHR, Grand Chamber, *Satakunnan Markkinapörssi Oy and Satamedia Oy v. Finland*, no. 931/13, *Judgment*, 27 June 2017, para. 171; *Castells v. Spain*, no. 11798/85, *Judgment*, 23 April 1992, para. 43; Grand Chamber, *Von Hannover v. Germany no. 2*, nos. 40660/08 and 60641/08, *Judgment*, 7 February 2012, para. 109; *Leempoel & S.A. ED. Ciné Revue v. Belgium*, no. 64772/01, *Judgment*, 9 November 2006, para. 68; *Standard Verlags GmbH v. Austria*, no. 21277/05, *Judgment*, 4 June 2009, para. 46; *Von Hannover v. Germany*, no. 59320/00, *Judgment*, 24 June 2004, para. 60; *Wingrove v. the United Kingdom*, no. 17419/90, *Judgment*, 25 November 1996, para. 58.

⁸⁰ ECtHR, *Dupuis and Others v. France*, no. 1914/02, *Judgment*, 7 June 2007, para. 42; *July and SARL Libération v. France*, no. 20893/03, *Judgment*, 14 February 2008, para. 66.

⁸¹ ECtHR, *White v. Sweden*, no. 42435/02, *Judgment*, 19 Shtator 2006, para. 29; *Egeland and Hanseid v. Norway*, no. 34438/04, *Judgment*, 16 April 2009, para. 58; *Leempoel & S.A. ED. Ciné Revue v. Belgium*, no. 64772/01, *Judgment*, 9 November 2006, para. 72; *Eerikäinen and Others v. Finland*, no. 3514/02, *Judgment*, 10 February 2009, para. 62.

⁸² *Shih për shembull*, ECtHR, Grand Chamber, *Morice v. France*, no. 29369/10, *Judgment*, 23 April 2015, para. 128.

të qartë se interesi publik nuk mund të kuptohet ngushtë vetëm si kureshtje e publikut apo si sensacionalizëm.⁸³

55. Bazuar në sa më lart, për qëllimin e bërjes së konstatimeve paraprahe mbi "interesin publik" në kontekstin e pranueshmërisë së provave, Trupi Gjykses ka marrë parasysh përkufizimin e këtij termi në nenin 200(4) të KPK-së dhe në jurisprudencën përkatëse të GJEDNJ-së lidhur me këtë aspekt.

(c) Konstatimet paraprahe të Trupit Gjykses lidhur me "interesin publik"

56. Trupi Gjykses vëren që në fillim se as Ligji dhe as Rregullorja nuk ofrojnë një bazë të qartë ligjore për mbrojtjen e "interesit publik" në lidhje me ndonjë nga veprat penale të përfshira në Aktakuzë. Vërehet më tej se palët nuk kundërshtojnë se mbrojtja e konfidencialitetit të hetimeve penale dhe e dëshmitarëve është një interes publik legjitim që përlij vendosjen e kufizimeve të caktuara të disa të drejtave themelore, ndër të cilat ushtrimi i lirisë së shprehjes dhe qasja në dokumente publike. Megjithatë, Mbrojtja pretendon se ekzistonte një "interes publik" konkurrues që është i rëndësishëm për marrjen e vendimit nëse kufizimi i lirisë së shprehjes së të akuzuarve do të ishte i nevojshëm dhe i arsyeshëm në rrethanat përkatëse. Vlerësimi i këtij pretendimi do të bëhet nga Trupi Gjykses pasi të ketë dëgjuar të gjitha provat e lidhura me atë aspekt gjatë gjykimit.

57. Megjithatë, në këtë fazë, Trupi Gjykses është në gjendje të bëjë konstatime paraprahe mbi pretendimet e Mbrojtjes se sa vijojnë përbëjnë "interes publik": (i) paragjykimet etnike të pretenduara të DHS-së; (ii) bashkëpunimi ndërmjet Serbisë dhe TFHS-së/ZPS-së; dhe (iii) përfshirja e disa zyrtarëve të shtetit serb në bashkëpunimin e lartpërmendur.

58. Lidhur me parashtrimin e Mbrojtjes së Haradinajt se "anshmëria" etnike e pretenduar e këtij juridiksioni do të përbënte "interes publik", Trupi Gjykses thekson

⁸³ ECtHR, Grand Chamber, *Couderc and Hachette Filipacchi Associés v. France*, no. 40454/07, *Judgment*, 10 November 2015, para. 101.

sa vijon. Së pari, mandati dhe juridiksioni i DHS-së janë përcaktuar dhe miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës në përputhje me garancitë përkatëse demokratike dhe kushtetuese. Së dyti, garancitë përkatëse të procedurave të drejta dhe të shpejta janë të detyrueshme për DHS-në, përfshirë edhe për këtë Trup Gjykues, pavarësisht prejardhjes, identitetit, përkatësisë etnike ose kombësisë së të akuzuarve. Së treti, Mbrojtja nuk ka vënë në dukje ndonjë material në informacionin që pretendohet se u zbulua nga të akuzuarit i cili të mbështesë pretendimin për "anshmëri" të DHS-së. Për rrjedhojë, Trupi Gjykues nuk do ta autorizojë Mbrojtjen që të thërrasë ose të kërkojë pranimin e provave që sipas saj mbështesin këtë pretendim.

59. Lidhur me bashkëpunimin ndërmjet Serbisë dhe TFHS-së/ZPS-së, nuk mund të kontestohet se kjo ishte e ditur për publikun dhe se është pjesë e ligjshme e mandateve të TFHS-së dhe ZPS-së.⁸⁴ Trupi Gjykues është gjithashtu i bindur që as TFHS-ja dhe as ZPS-ja nuk kishin autoritetin apo mundësinë praktike që t'i zgjidhnin apo për zgjidhnin zyrtarët në Republikën e Serbisë me të cilët të bashkëpunonin në lidhje me përmbushjen e mandateve të tyre.⁸⁵ Në përputhje me jurisprudencën e lartpërmendur të GJEDNJ-së, një bashkëpunim përndryshe i ligjshëm do të përbente çështje me interes publik vetëm në qoftë se dhe kur ka prova të parregullsive që do të ndikonin në pavarësinë, paanshmërinë ose integritetin e hetimit(hetimeve) të TFHS-së/ZPS-së.⁸⁶ Për rrjedhojë, gjatë vlerësimit të lidhjes së pretenduar të dëshmitarëve të propozuar që thuhet se do të thirren të dëshmojnë në lidhje me "interesin publik" të pretenduar, Trupi Gjykues do të duhet të verifikojë nëse dëshmitarët e propozuar janë në gjendje të japin dëshmi që do të sugjeronin se disa nga materialet e supozuara të

⁸⁴ *Shih, në përgjithësi*, Parashtrimet e Mbrojtjes së Gucatit në Pajtim me Urdhrin Gojor, para. 11-14; Parashtrimet e Mbrojtjes së Haradinajt në Pajtim me Urdhrin Gojor, para. 40, 43-44.

⁸⁵ Transkript, 1 shtator, 2021, f. 476, rreshtat 1-16; Parashtrimet e Mbrojtjes së Gucatit në Pajtim me Urdhrin Gojor, para. 11-23; Parashtrimet e Mbrojtjes së Haradinajt në Pajtim me Urdhrin Gojor, para 36-47.

⁸⁶ *Shih gjithashtu* Parashtrimet e Mbrojtjes së Gucatit në Pajtim me Urdhrin Gojor, para. 12(c).

nxjerra nga të akuzuarit përmbajnë tregues për parregullsi në bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Serbisë (ose zyrtarëve të saj) dhe TFHS-së/ZPS-së.

60. Lidhur me përfshirjen e disa zyrtarëve të shtetit serb në bashkëpunimin e lartpërmendur, Trupi Gjykses vëren se ai nuk ka dëgjuar dhe as nuk ka marrë prova për asnjë nga individët e përmendur në materialin e kundërshtuar që ata të jenë dënuar penalisht për ndonjë krim të lidhur me çështjen.⁸⁷ Për rrjedhojë, ata gëzojnë prezumimin e pafajësisë⁸⁸ dhe reputacioni i tyre mbrohet nën kornizën e përgjithshme të së drejtës së tyre për jetë familjare dhe për privatësi.⁸⁹ Për më tepër, Trupi Gjykses nuk ka për detyrë dhe as nuk është në pozitë të gjykojë në lidhje me përgjegjësinë e ndonjë individi tjetër përveç të akuzuarve. Për rrjedhojë, çdo sugjerim i Mbrojtjes së përfshirja e ndonjërit prej këtyre individëve në bashkëpunimin me TFHS-në/ZPS-në përbën tregues parregullsie, duhet të marrë parasysh mbrojtjen e të drejtave të tyre themelore.

61. Bazuar në sa më lart, “interesi publik” i pretenduar lidhur me të cilin është e lejueshme të merren dëshmi të lidhura me çështjen kufizohet në provat që do të sugjeronin se disa nga materialet që pretendohet se janë nxjerrë nga të akuzuarit përmbajnë tregues të parregullsive të kryera në kontekstin e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Serbisë (ose zyrtarëve të saj) dhe SITF-së/ZPS-së, të cilat do të kishin ndikuar mbi pavarësinë, paanësinë ose integritetin e hetimeve të TFHS-së/ZPS-së.

⁸⁷ Trupi Gjykses vëren se ka marrë dhe dëgjuar prova se disa prej këtyre individëve janë hetuar ose kanë qenë objekt i masave kufizuese në lidhje me sjelljen e tyre në të kaluarën. *Shih për shembull*, Transkripti, 20 tetor 2021, f. 1097-1098, 1133 e në vijim; P00124ET. Megjithatë, këto prova nuk tregojnë për dënime penale për ndonjë krim që lidhet me pretendimet në lidhje me interesin publik që ngre Mbrojtja. Trupi Gjykses vëren më tej se disa prej këtyre parashtrimeve bazohen në artikuj të mediave.

⁸⁸ *Shih për shembull*, ECtHR, *Ismoilov and others v. Russia*, no. 2947/06, *Judgment*, 24 April 2008, para. 160; *Larrañaga Arando and others v. Spain*, no. 73911/16, *Decision*, 18 July 2019, para. 40.

⁸⁹ *Shih për shembull*, ECtHR, *Ageyev v. Russia*, no. 7075/10, *Judgment*, 18 April 2013, paras 238-239; Grand Chamber, *Von Hannover v. Germany (no. 2)*, nos. 40660/08 and 60641/08, *Judgment*, paras 95-99; Grand Chamber, *Axel Springer AG v. Germany*, no. 39954/08, *Judgment*, 7 February 2012, paras 82-84; *Pfeifer v. Austria*, no. 12556/03, *Judgment*, 15 November 2007, para. 35. *Shih gjithashtu Iishkariani v. Georgia*, no. 18925/09, *Judgment*, 20 September 2018, para. 62-63.

Rëndësia e dëshmive të dëshmitarëve të propozuar në lidhje me të cilët bëhet kjo kërkesë, do të shqyrtohet mbi këtë bazë.

4. Pranueshmëria e dëshmive të ekspertëve

62. Trupi Gjykses vëren që në fillim se as Ligji dhe as Rregullorja nuk japin përkufizimin e dëshmitarit ekspert. Rregulla 149(2)(a) e Rregullores kërkon shprehimisht që dëshmitari ekspert të ketë kualifikimet e nevojshme dhe që dëshmia e tij ose e saj të ketë lidhje me procesin gjyqësor.

63. Provat e ekspertit janë të pranueshme në qoftë se: (i) dëshmitari i propozuar mund të konsiderohet si ekspert; (ii) provat e ekspertit plotësojnë kriteret e rregullës 138(1) të Rregullores, përfshirë në lidhje me standardet minimale të besueshmërisë, lidhjes me lëndën dhe vlerës provuese; dhe (iii) përmbajtja e deklaratave ose aktekspertizave të ekspertit bien në fushën e ekspertizës së pranuar të ekspertit dhe është e lejueshme.⁹⁰

64. Lidhur me kushtin e parë, sipas kuptimit të rregullës 149 të Rregullores eksperti mund të përkufizohet si “[një] person i cili për shkak të disa njohurive, aftësive ose trajnimeve të specializuara mund të ndihmojë gjyksesin e fakteve të kuptojë ose të vendosë lidhur me objektin e mosmarrëveshjes”.⁹¹

⁹⁰ Për ngjashmëri, ICTY, *Prosecutor v. Milan Martić*, IT-95-11-T, Trial Chamber, [Decision on Defence's Submission of the Expert Report of Milisav Sekulić Pursuant to Rule 94bis, and on Prosecution's Motion to Exclude Certain Sections of the Military Expert Report of Milisav Sekulić, and on Prosecution Motion to Reconsider Order of 7 November 2006](#), 13 November 2006, pp 3-4; *Prosecutor v. Dragomir Milošević*, IT-98-29/1-T, Trial Chamber, [Decision on Admission of Expert Report of Robert Donia](#), 15 February 2007, para. 8; *Prosecutor v. Milan Martić*, IT-95-11-T, Trial Chamber, [Decision on Defence's Submission of the Expert Report of Professor Smilja Avramov Pursuant to Rule 94bis](#), 9 November 2006.

⁹¹ Për ngjashmëri, ICTY, *Prosecutor v. Galić*, IT-98-29, Trial Chamber, [Decision Concerning the Expert Witnesses Ewa Tabeau and Richard Philips](#), 3 July 2002, f.2; *Prosecutor v. Brđanin*, IT-99-36-Y, [Decision on Prosecution's Submission of Statement of Expert Witness Ewan Brown](#), 3 June 2003, f. 4; *Prosecutor v. Strugar*, IT-01-42-PT, Trial Chamber, [Decision on the Defence Motions to Oppose Admission of Prosecution Expert Reports Pursuant to Rule 94 bis](#), 1 April 2004, f. 4; *Prosecutor v. Stanišić & Simatović*, IT-03-69-PT, Trial Chamber, [Decision on Prosecution's Submission of the Expert Report of Nena Tromp and Christiam Nielsen Pursuant to Rule 94 bis](#), 18 March 2008, para. 8; *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-T, Trial Chamber, [Decision on Expert Reports by Richard Butler](#), 4 March 2009, para. 9; *Prosecutor v. Martić*, IT-95-11-T, Trial Chamber,

65. Lidhur me kushtin e dytë, ashtu si edhe me provat e tjera të propozuara, detyrimi për të vërtetuar përmbushjen e kushteve të pranueshmërisë i takon palës që kërkon t'i paraqesë ato prova.⁹²

66. Lidhur me kushtin e tretë, opinioni i ekspertit që përmbush kriterin e lejueshmërisë duhet të përfshijë domosdoshmërisht njohuri të specializuara ose përvoja të cilat e bëjnë individin në fjalë të aftë të japë dëshmi që përndryshe do të ishin përtej përvojës dhe njohurive të Trupit Gjykses. Në këtë kuptim, qëllimi dhe arsyetimi në favor të dëshmisë së ekspertit është që të sqarojë ose të ndihmojë Trupin Gjykses me njohuri të specializuara të cilat Trupi Gjykses nuk i zotëron.⁹³ Njohuri të tilla të specializuara jo vetëm që janë parakusht për dhënien e dëshmisë nga eksperti, por përbëjnë edhe një kufizim të brendshëm lidhur me të. Dëshmia e ekspertit faktikisht kufizohet në fushën ose fushat e njohurive të specializuara të ekspertit dhe në parim nuk mund të dalin jashtë asaj fushe ekspertize.⁹⁴ Në qoftë se dëshmia që propozohet të japë eksperti është brenda njohurive të Trupit Gjykses, ose nëse çështja

[Decision on Prosecution's Motions for Admission of Transcripts Pursuant to Rule 92 bis \(D\) and of Expert Reports Pursuant to Rule 94 bis](#), 13 January 2006, para. 37; *Prosecutor v. Milošević*, IT-98-29/1-T, Trial Chamber, [Decision on Defence Expert Witnesses](#), 21 August 2007, para. 6; SCSL, *Prosecutor v. Taylor*, 03-01-T, Trial Chamber, [Decision on Defence application to exclude the evidence of proposed Prosecution expert witness Corinne Dufka or, in the alternative, to limit its scope and on urgent Prosecution request for decision](#), 19 June 2008, paras 7-8; *Prosecutor v. Brima et al.*, 04-16-T-365, Trial Chamber, [Decision on Prosecution Request for Leave to Call an Additional Witness \(Zainab Hawa Bangura\) Pursuant to Rule 73bis\(E\), AND on Joint Defence Notice to Inform the Trial Chamber of Its Position Vis-a-vis the Proposed Expert Witness \(Mrs. Bangura\) Pursuant to Rule 94bis](#), 5 August 2005, paras 23, 31; *Prosecutor v. Norman et al.*, 04-14-T, Trial Chamber [Decision on Prosecution Request for Leave to Call Additional Witnesses and for Orders for Protective Measures](#), 21 June 2005; *Prosecutor v. Sesay et al.*, 04-15-T, Trial Chamber, [Decision on Prosecution Request for Leave to Call an Additional Expert Witness](#), 10 June 2005.

⁹² Për ngjashmëri, ICTY, *Prosecutor v. Galić*, IT-98-29-A, Appeals Chamber, [Decision on the Expert Witness Statement Submitted by the Defence](#), 27 January 2003, f. 3; *Prosecutor v. Galić*, IT-98-29-A, Appeals Chamber, [Decision concerning the Expert Witness Ewa Tabeau and Richard Philipps](#), 3 July 2002, f. 3.

⁹³ Për ngjashmëri, SCSL, *Prosecutor v Norman*, 2004-14-AR72(E), Appeals Chamber, [Decision on Prosecution Request for Leave to Call Additional Witnesses and for Orders for Protective Measures](#), 21 June 2005, f. 4; ICTR, *Prosecutor v Akayesu*, ICTR-96-4-A, Appeals Chamber, [Decision by a Defence Motion for the Appearance of an Accused as an Expert Witness](#), 9 March 1998, f. 2.

⁹⁴ Për ngjashmëri, ICTY, *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-T, Trial Chamber, [Decision on Expert Reports by Richard Butler](#), 4 March 2009, para. 9; *Prosecutor v. Martić*, IT-95-11-T, Trial Chamber, [Decision on Defence's Submission of the Expert Report of Professor Smilja Avramov Pursuant to Rule 94 bis](#), 9 November 2006, para. 7.

është e tillë që gjykata mund të vendosë në bazë të përvojës së vet, dëshmia e ekspertit mund të mos pranohet.⁹⁵ Për rrjedhojë, dëshmia e ekspertit nuk duhet të përdoret për t'i paraqitur Trupit Gjykses fakte ose rrethana të cilat ai mund t'i përcaktojë vetë, ose për ta udhëzuar atë Trup Gjykses në lidhje me aspekte që përfshihen në kapacitetin e zakonshëm të gjykatësve për t'i përcaktuar vetë.⁹⁶ Në veçanti, eksperti nuk duhet të japë opinionin e tij/saj lidhur me përgjegjësinë penale të të akuzuarit, që është pjesë e kompetencës ekskluzive të Trupit Gjykses.⁹⁷

C. DËSHMITË E PROPOZUARA TË DËSHMITARËVE DW1241, 1242, 1246, 1250 DHE 1251

1. Dëshmitarët DW1246, 1250 dhe 1251

67. Në kërkesën e parë të Kërkesës për Heqje nga Lista, ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses të urdhërojë heqjen e pesë dëshmitarëve nga Lista Paraprake e Dëshmitarëve të Mbrojtjes (dëshmitarët 11, 15, 16, 18 dhe 19).⁹⁸ Trupi Gjykses vëren se dëshmitarët 11 dhe 18 nuk propozohen më të thërriten. Trupi Gjykses nuk do të trajtojë parashtrimet lidhur me ta. Trupi Gjykses vëren më tej se dëshmitarët 15, 16 dhe 19 tani identifikohen përkatësisht si dëshmitarët DW1250, DW1251 dhe DW1246. Trupi Gjykses do të trajtojë parashtrimet lidhur me ta duke përdorur numrat e fundit.

⁹⁵ F00314, Trupi Gjykses, *Urdhër mbi Zhvillimin e Procedurave* ("Urdhri mbi Zhvillimin e Procedurave"), para. 89.

⁹⁶ Urdhër mbi Zhvillimin e Procedurave, para. 90. *Për ngjashmëri*, ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-1159, Trial Chamber VI, [Decision on Defence Preliminary Challenges to Prosecution's Expert Witnesses](#), 9 February 2016, para. 8; ICTR, *Prosecutor v. Karemera et al.*, ICTR-98-44-T, Trial Chamber, [Decision on Prosecution motion for reconsideration of the decision on prospective experts Guichaoua, Nowrojee and Des Forges, or for certification](#), 16 November 2007, para. 21

⁹⁷ *Për ngjashmëri*, ICTY, *Prosecutor v. Hadžihasanović et al.*, IT-01-47-T, Trial Chamber [Decision on Report of Prosecution Expert Klaus Reinhardt](#), 11 February 2004, f. 4; *Prosecutor v. Stanišić & Simatović*, IT-03-69-PT, Trial Chamber, [Decision on Prosecution's Submission of the Expert Report of Nena Tromp and Christiam Nielsen Pursuant to Rule 94 bis](#), 18 March 2008, para. 12; *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-T, Trial Chamber, [Decision on Expert Reports by Richard Butler](#), 4 March 2009, para. 10.

⁹⁸ Kërkesa për Heqje nga Lista, para. 1.

(a) Parashtrimet e palëve

68. Në listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes, DW1246-a përshkruhet si një ish-oficer i nivelit të lartë i Policisë së Kosovës. Mbrojtja parashtron se ky dëshmitar propozohet të japë dëshmi lidhur me “hetimin efektiv për sigurimin e objekteve të Shoqatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL-UÇK”) dhe kërkimin e identifikimit se kush ishte përgjegjës për lënien e materialeve dhe rrjedhjen e informacionit”.⁹⁹ Në të njëjtin parashtrim, DW1250 dhe DW1251 identifikohen si dëshmitarë të lidhur me argumentin mbrojtës të “interesit publik”.¹⁰⁰

69. Në parashtrimet paraprake të Mbrojtjes lidhur me dëshmitarët, Mbrojtja parashtron se DW1246-a do të thirret për të dëshmuar se “Policia e Kosovës mori udhëzime nga Prokuroria Speciale e Kosovës që të mos kryente hetime për dërgesat”.¹⁰¹ Në të njëjtin parashtrim, lidhur me DW1250-n, Mbrojtja informon se ai do të dëshmojë lidhur me praktikën e EULEX-it/DHS-së, nëse ka një atmosferë presioni politik, nëse dosjet hetimore dhe të dhënat e dëshmitarëve të mbrojtur u janë dhënë zyrtarëve serbë, nëse ekziston një kulturë e rrjedhjes së informacionit dhe nëse të akuzuarit vepruan në interesin publik/mund të klasifikohen si sinjalizues.¹⁰² Lidhur me DW1251-shin, Mbrojtja parashtron se ajo do të dëshmojë për praktikën e EULEX-it/DHS-së, nëse ka një atmosferë presioni politik, nëse dosjet hetimore dhe hollësitë e dëshmitarëve të mbrojtur u janë dhënë zyrtarëve serbë, nëse ekziston një kulturë e rrjedhjes së informacionit dhe nëse të akuzuarit vepruan në interesin publik/mund të klasifikohet si sinjalizues.¹⁰³

⁹⁹ Listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes, f. 2.

¹⁰⁰ Listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes, f. 2.

¹⁰¹ Parashtrime Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Gucatit, f. 5; Parashtrime Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Haradinajt, f. 8.

¹⁰² Parashtrime Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Gucatit, f. 5; Parashtrime Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Haradinajt, f. 7-8.

¹⁰³ Parashtrime Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Gucatit, f. 5; Parashtrime Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Haradinajt, f. 7-8.

70. Në Kërkesën për Heqje nga Lista, ZPS-ja parashtron se dëshmitarët DW1246, DW1250 dhe DW1251 nuk duhet të lejohen të dëshmojnë për shkak se ata nuk kanë lidhje me ndonjë fakt material në këtë proces.¹⁰⁴

71. Mbrojtja e Haradinajt përgjigjet se provat e propozuara të DW1246-ës provojnë faktin se me gjithë autoritetin dhe përgjegjësinë që ka, ZPS-ja nuk i ka hetuar mjaftueshëm këto krime, të cilat ajo pranon se përfshihen në juridiksionin e DHS-së.¹⁰⁵ Lidhur me dëshmitarët DW1250 dhe DW1251, Mbrojtja e Haradinajt përgjigjet se ata "janë në gjendje të paraqesin prova të rëndësishme për mbrojtjen e interesit publik", duke theksuar se të dy janë cilësuar si "sinjalizues" për nxjerrjet e informacionit që kanë bërë në të kaluarën dhe në veçanti për transferimin e palejueshëm të dosjeve të lëndëve dhe të dhënave të dëshmitarëve të mbrojtur tek zyrtarët serbë. Mbrojtja e Haradinajt shton se njohuritë e veçanta të DW1250-ës dhe DW1251-shit janë të rëndësishme për mbrojtjen që mund të kërkojë të paraqesë i akuzuari.¹⁰⁶

72. Pas parashtrimeve sipas rregullës 119(2), Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi një deklaratë të propozuar të DW1246-ës,¹⁰⁷ ku dha një pasqyrë të përgjithshme të disa veprimeve të ndërmarra nga Policia e Kosovës në lidhje me rrjedhjen e informacionit të TFHS-së/ZPS-së dhe ndërveprimeve ndërmjet Policisë së Kosovës dhe OVL-UÇK-së. Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi edhe deklaratat e propozuara në lidhje me DW1250-n dhe DW1251-shin.¹⁰⁸

73. Në konferencën përgatitore për Mbrojtjen, ZPS-ja parashtrroi se deklaratat e dëshmitarëve DW1246, DW1250, DW1251, të nxjerra më 30 nëntor dhe 1 dhjetor 2021, e përforconin kërkesën e saj të parë, për shkak se deklaratat e bënin edhe më të qartë

¹⁰⁴ Kërkesa për Heqje nga Lista, para. 1-2, 8-16.

¹⁰⁵ Përgjigjja e Haradinajt, para. 36.

¹⁰⁶ Përgjigjja e Haradinajt, para. 34.

¹⁰⁷ Deklaratat e dëshmitarëve të propozuar të Haradinajt, f. 8-10.

¹⁰⁸ Deklaratat e dëshmitarëve të propozuar të Haradinajt, f. 11-36; Deklarata e propozuar e DW1250-ës iu dërgua Trupit Gjykses nga avokati i z. Haradinaj me postë elektronike më 1 dhjetor 2021 në orën 14:50 (CRSPD72).

natyrën e parëndësishme të dëshmive të mundshme të këtyre dëshmitarëve dhe faktin se ata nuk mund ta ndihmojnë Trupin Gjykses.¹⁰⁹

74. Në të njëjtën seancë, Mbrojtja e Haradinajt u përgjigj se DW1246 ka lidhje me çështjen, sepse ai trajton nëse ZPS-ja ka urdhëruar apo ka penguar në mënyrë aktive Policinë e Kosovës për të kryer hetime, duke theksuar se DW1246 ishte anëtar i lartë i Policisë së Kosovës në kohën përkatëse.¹¹⁰ Lidhur me dëshmitarët DW1250 dhe DW1251, Mbrojtja e Haradinajt përsëriti se dëshmitë e propozuara të tyre ishin të rëndësishme dhe të nevojshme për argumentin e z. Haradinaj lidhur me mbrojtjen e interesit publik.¹¹¹

(b) Konstatimet e Trupit Gjykses

75. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e Haradinajt ka pasur së paku pesë herë mundësi për të shpjeguar dhe paraqitur rëndësinë e pretenduar të dëshmitarëve të kundërshtuar, përkatësisht:

- i. në dosjet e tyre paraprake, ku Mbrojtja u ftua të saktësonte, për dëshmitar, “se me cilin aspekt të veçantë lidhen provat”;¹¹²
- ii. Në parashtrimet paraprake të mbrojtjes lidhur me dëshmitarët, të dorëzuara në përputhje me Urdhrin e 21 Korrikut të Trupit Gjykses për të përshkruar natyrën e dëshmive të propozuara të dëshmitarëve të renditur në listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes;¹¹³

¹⁰⁹ Versioni jopërfundimtar i transkriptit, 2 dhjetor 2021, f. 2064-2066.

¹¹⁰ Versioni jopërfundimtar i transkriptit, 2 dhjetor 2021, f. 2073.

¹¹¹ Versioni jopërfundimtar i transkriptit, 2 dhjetor 2021, f. 2074.

¹¹² Rregulla 95(5) e Rregullores; *Shih gjithashtu* Dosja Paraprake e Gucatit; Dosja Paraprake e Haradinajt; listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes.

¹¹³ Urdhri i 21 Korrikut, para. 12, 34 (e); Parashtrime Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Gucatit; Parashtrime Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Haradinajt.

- iii. në konferencën përgatitore për gjykim, kur Trupi Gjykses kërkoi shprehimisht nga Mbrojtja që të qartësonte qëndrimin e saj për këtë çështje;¹¹⁴
- iv. në përgjigjet e tyre ndaj Kërkesës për Heqje nga Lista;¹¹⁵ dhe
- v. në listat e dëshmitarëve të propozuar të dorëzuara me parashtrimet e tyre sipas rregullës 119(2) në vijim të kërkesës për të treguar, për secilin dëshmitar, "pretendimet në aktakuzë në lidhje me të cilat pritet të dëshmojë secili dëshmitar, duke përmendur konkretisht akuzat dhe paragrafët përkatës të aktakuzës" (rregulla 119(2) e Rregullores), dhe në deklaratat e dëshmitarëve të dorëzuara në vijim të parashtrimeve sipas rregullës 119(2).¹¹⁶

76. Trupi Gjykses shqyrtoi të gjitha parashtrimet e lartpërmendura dhe konstaton si më poshtë.

Dëshmitari DW1246

77. Trupi Gjykses vëren se provat e propozuara duket se janë parashtruar si të lidhura me pretendimin e "shtytjes për kryerje të veprës penale" të paraqitur nga Mbrojtja. Pa paragjykuar aspektin e disponueshmërisë së argumentit mbrojtës së shtytjes sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm, Trupi Gjykses konsideron se provat e propozuara mund të kenë lidhje me atë aspekt.

78. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se deklarata e propozuar e DW1246-ës përmban shumë materiale me pak ose aspak lidhje me procesin gjyqësor. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i udhëzon palët që të sigurojnë që marrja në pyetje të kufizohet në çështje dhe rrethana që kanë lidhje me procesin aktual.

¹¹⁴ *Shih për shembull*, Transkript, 1 shtator 2021, f. 463-464.

¹¹⁵ Përgjigja e Gucatit; Përgjigja e Haradinajt.

¹¹⁶ Deklaratat e Dëshmitarëve të Propozuar të Haradinajt.

79. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykues rrëzon pjesërisht kërkesën e parë dhe refuzon të përjashtojë dëshminë e DW1246-ës.

Dëshmitarët DW1250 dhe DW1251

80. Trupi Gjykues vëren se përshkrimet e mëparshme të Mbrojtjes lidhur me dëshmitë e pritshme dhe deklaratat e dhëna nga DW1250 dhe DW1251 trajtojnë pretendime të përgjithshme në lidhje me veprimtaritë dhe funksionimin e EULEX-it, theksojnë parregullsi dhe/ose sjellje kundërvajtëse të pretenduara në EULEX. As parashtrimet e Mbrojtjes, dhe as deklaratat e propozuara, nuk ofrojnë ndonjë lidhje të besueshme me hetimet e TFHS-së/ZPS-së, kontaktet e TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe apo procedurat e DHS-së. Për më tepër, deklaratat e dëshmitarëve të propozuar nuk duket se kanë lidhje me ndonjë fakt apo rrethanë të rëndësishme për këtë çështje. Pretendimet e përgjithshme për parregullsi ose sjellje kundërvajtëse që dëshmitarët e propozuar u atribuojnë zyrtarëve të ndryshëm të EULEX-it, që nuk kanë të bëjnë me hetimet e TFHS-së/ZPS-së ose procedurat e DHS-së, nuk janë dëshmuar nga Mbrojtja të kenë lidhje me ndonjë aspekt në këtë çështje. Trupi Gjykues vëren gjithashtu se, duke qenë se dëshmitë e propozuara kanë lidhje me një mosmarrëveshje ndërmjet EULEX-it ose ndonjë punëdhënësi tjetër dhe ish-punonjësve të tij, DHS-ja nuk është forumi i duhur për gjykimin e një mosmarrëveshje të tillë.

81. Trupi Gjykues vëren më tej se për asnjërin prej këtyre dëshmitarëve nuk është dëshmuar se zotëron ekspertizë që ka lidhje me çështjen, që do t'i autorizonte ata të jepnin dëshmi sipas rregullës 149 të Rregullores se të akuzuarit kanë vepruar në interesin publik dhe duhet të konsiderohen si sinjalizues. Për më tepër, pretendimi se DW1250 dhe DW1251 duhet të konsiderohen si "sinjalizues" sipas nenit 10 të KEDNJ-së, cenohet nga fakti se, nga materiali i parashtruar nga Mbrojtja, duket se as DW1250 dhe as DW1251 nuk kanë pasur ndonjëherë marrëdhënie punësimi me ZPS-në apo

TFHS-në, që do të përlligjte njohjen e statusit të sinjalizuesit në kontekstin aktual.¹¹⁷ Për rrjedhojë, Trupi Gjykses është bindur e Mbrojtja e Haradinajt nuk ka arritur të dëshmojë se si është në gjendje secili prej këtyre dëshmitarëve të dëshmojë në lidhje me pretendimin e “interesit publik” siç ai identifikohet dhe përkufizohet më lart,¹¹⁸ dhe se si lidhen provat e propozuara prej tyre me këtë proces gjyqsor.

82. Bazuar të sa më lart, Trupi Gjykses pranon pjesërisht kërkesën e parë dhe refuzon të dëgjojë dëshmitë e DW1250-ës dhe DW1251-shit.

2. Dëshmitarët DW1241 dhe DW1242

83. Në bazë të kërkesës së dytë në Kërkesën për Heqje nga Lista, ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses të urdhërojë mosmiratimin e dëshmime të caktuara të pesë dëshmitarëve nga listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes (dëshmitarët 1, 3, 9, 12 dhe 14). Trupi Gjykses vëren se dëshmitarët 1, 9 dhe 14 nuk propozohen më të thirren për të dëshmuar. Trupi Gjykses nuk do të trajtojë parashtrimet lidhur me ta. Trupi Gjykses vëren më tej se dëshmitarët 3 dhe 12 tani identifikohen si dëshmitarët DW1241 dhe DW1242. Trupi Gjykses do të trajtojë parashtrimet lidhur me ta duke përdorur numrat e fundit.

(c) Parashtrimet e palëve

84. Në listat paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes, DW1241 dhe DW1242 përshkruhen si dëshmitarë në lidhje me argumentin mbrojtës të interesit publik, të cilët do të japin dëshmi mbi ngjarjet faktike që kanë lidhje me dorëzimin e materialeve dhe konferencat për shtyp, si dhe me pretendimin për nxitje prej ZPS-së.¹¹⁹

¹¹⁷ *Shih për shembull*, ECtHR, Grand Chamber, [Guja v. Moldova](#), no 14277/04, Judgment, 12 February 2008, para. 70. Trupi Gjykses vëren se një dëshmitar i propozuar i Mbrojtjes, DW1252, do të dëshmojë se ky kriter nuk zbatohet në këtë proces. *Shih* Aktekspertiza e Majersit, para. 11, 13, 20-21. Trupi Gjykses do të vendosë lidhur me këtë aspekt në vendimin e tij në përfundim të gjykimit.

¹¹⁸ *Shih më lart* para. **Error! Reference source not found.-Error! Reference source not found.**

¹¹⁹ Lista Paraprake e Dëshmitarëve të Gucatit, f. 1-2; Lista Paraprake e Dëshmitarëve të Haradinajt, f. 1.

85. Në parashtrimet paraprake të Mbrojtjes lidhur me dëshmitarët, Mbrojtja parashtron se DW1241 do të japë dëshmi mbi rrethanat e dërgesave dhe sjelljen e punonjësve të ZPS-së të pranishëm në objektet e OVL-UÇK-së më 25 shtator 2020.¹²⁰ Në të njëjtin parashtrim, Mbrojtja përshkruan se DW1242 e kishte parë me sytë e vet dhe kishte filmuar dërgesën e dytë nga jashtë OVL-UÇK-së.¹²¹ Mbrojtja pretendon se DW1242 do të dëshmojë për "rrethanat e konferencës për shtyp" dhe se "nuk ishte kontaktuar nga ZPS-ja për hetimin e pamjeve filmike të dërgesës së dytë".¹²²

86. Në kërkesën e saj të dytë, ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses të mos autorizojë dëshmitë e DW1241-shit dhe DW1242-shit për aspekte që nuk kanë lidhje me akuzat. Lidhur me DW1241-in, ZPS-ja parashtron se provat mbi mënyrën se si u krye kontrollimi dhe sekuestrimi nga ZPS-ja nuk do ta ndihmonin Trupin Gjykses për të marrë vendim lidhur me akuzat, por do të zgjasnin në mënyrë të panevojshme procesin, duke shkaktuar një sforcim të panevojshëm mbi kapacitetet institucionale.¹²³ Lidhur me DW1242-in, ZPS-ja parashtron se provat lidhur me hapat që mund ose mund të mos ketë ndërmarrë ZPS-ja në kontekstin e hetimit të saj se si mbërritën paketat në OVL-UÇK, nuk janë objekt i gjykimit dhe nuk kanë lidhje me akuzat.¹²⁴

87. Mbrojtja e Gucatit nuk bëri parashtrime konkrete lidhur me DW1241-in dhe DW1242-in në përgjigjen e saj.

(d) Konstatimet e Trupit Gjykses

88. Trupi Gjykses vëren se DW1241 dhe DW1242 duken të aftë për të dhënë dëshmi që lidhen me këtë çështje, veçanërisht lidhur me rrethanat në të cilat materiali

¹²⁰ Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Gucatit, f. 4; Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Haradinajt, f. 7.

¹²¹ Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Gucatit, f. 2; Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Haradinajt, f. 5.

¹²² Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Gucatit, f. 2; Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Haradinajt, f. 5.

¹²³ Kërkesa për Heqje nga Lista, para. 17-19.

¹²⁴ Kërkesa për Heqje nga Lista, para. 17-18.

i kundërshtuar erdhi në zotërim të të akuzuarve dhe operacionet e ndryshme të kontrollimit dhe konfiskimit që u kryen për ta rimarrë atë material nga OVL-UÇK-ja. Ndonëse aspekte të caktuara të provave të propozuara prej tyre mund të mos kenë lidhje me çështjen dhe, për rrjedhojë, nuk do të ishin të pranueshme, në këtë fazë teorikisht nuk është e mundur të përjashtohen linjat e mundshme të hetimit që Mbrojtja mund të dëshirojë të ndjekë me ta.

89. Sidoqoftë, Trupi Gjykses e udhëzon Mbrojtjen që të sigurojë që marrja në pyetje të kufizohet në aspektet dhe rrethanat e lidhura me këtë çështje, edhe për sa i përket aspekteve të “interesit publik” siç përkufizohet më lart.¹²⁵ Nëse ZPS-ja është e mendimit se po jepet dëshmi që nuk ka lidhje me çështjen, ajo mund të kundërshtojë mbi atë bazë gjatë marrjes në pyetje dhe të kërkojë një vendim nga Trupi Gjykses në atë kohë.

90. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses e rrëzon kërkesën e dytë si të parakohshme dhe refuzon të përjashtojë, në këtë kohë, pjesë të dëshmive të pritshme të DW1241-it dhe DW1242-it.

D. DËSHMITË E PROPOZUARA TË EKSPERTËVE DW1252 DHE DW1253

91. Trupi Gjykses vëren se znj. Majers është identifikuar nga Mbrojtja e Haradinajt si DW1252 dhe dëshmitari i dytë ekspert si DW1253.¹²⁶ Trupi Gjykses do të trajtojë parashtrimet në lidhje me këta dy dëshmitarë duke përdorur numrat e fundit dhe, në rastin e znj. Majers, duke iu referuar edhe emrit të saj.

¹²⁵ *Shih më lart* para. **Error! Reference source not found.-Error! Reference source not found..**

¹²⁶ Lista Paraprake e Dëshmitarëve të Haradinajt, f. 5-6.

3. Dëshmitarja DW1252 (znj. Majers)

(e) Parashtrimet e palëve

92. Mbrojtja parashtron se Aktekspertiza e Majersit trajton pyetjen nëse të akuzuarit mund të përshkruhen se kanë vepruar në interesin publik ose mund të klasifikohet si sinjalizues.¹²⁷

93. ZPS-ja e kundërshton pranueshmërinë e Aktekspertizës së Majersit për katër arsye, përkatësisht se: (i) interesi publik nuk mund të përbëjë mbrojtje ndaj akuzave kundër të akuzuarve; (ii) Aktekspertiza e Majersit dhe/ose dëshmia e znj. Majers nuk do ta ndihmonin Trupin Gjykses; (iii) Aktekspertiza e Majersit dhe/ose dëshmia e znj. Majers do të uzurponte në mënyrë të papërshtatshme funksionet e Trupit Gjykses; dhe (iv) Aktekspertiza e Majersit është përgatitur mbi një bazë të palejueshme.¹²⁸

94. Në përgjigjen e saj, Mbrojtja e Haradinajt i kundërshton këto arsye si bazë për refuzimin e dëshmisë së znj. Majers si eksperte në këtë çështje.¹²⁹

(f) Konstatimet e Trupit Gjykses

95. Trupi Gjykses vëren që në fillim se palët nuk e kundërshtojnë autoritetin e tij për të refuzuar të dëgjojë dëshminë e një eksperti të propozuar nëse dhe kur dëshmia e propozuar e dëshmitarit nuk ka lidhje me çështjen, ose kur lidhet me aspekte që nuk e justifikojnë marrjen e mendimit të ekspertit. Për rrjedhojë, pyetja për Trupin Gjykses është nëse ndonjë nga arsyet e parashtruara nga ZPS-ja justifikon një urdhër të Trupit Gjykses që e ndalon Mbrojtjen të thërrasë znj. Majers, ose ngushton kuadrin e dëshmisë që mund të merret në mënyrë të vlefshme prej saj.

¹²⁷ Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Gucatit, f. 5; Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Haradinajt, f. 8.

¹²⁸ Kundërshtimi për Majersin, para. 4-11.

¹²⁹ Përgjigje ndaj Kundërshtimit të Majersit. *Shih gjithashtu* F00410/RED.

96. Lidhur me argumentin e ZPS-së se interesi publik nuk mund të përbëjë mbrojtje ndaj akuzave kundër të akuzuarve, Trupi Gjykses përsërit se as Ligji dhe as Rregullorja nuk ofrojnë një bazë të qartë ligjore për mbrojtjen e "interetit publik" në lidhje me asnjë nga akuzat e paraqitura në Aktakuzë.¹³⁰ Megjithatë, pretendimi i "interetit publik" mund të ketë lidhje me çështjen, në përputhje me nenin 200(4) të KPK-së dhe jurisprudencën përkatëse të GJEDNJ-së, siç përshkruhet në paragrafët **Error! Reference source not found.-Error! Reference source not found.** dhe 61 të këtij vendimi. Mbi këtë bazë, provat që *mund* të ndihmojnë për të kuptuar parametrat ligjorë të zbatimit të këtij nocioni mund të jenë të rëndësishme për këtë proces. Për rrjedhojë, fakti që, siç theksohet nga ZPS-ja, "interesi publik" nuk është mbrojtje ndaj akuzave, nuk përbën bazë për refuzimin e dëshmisë së znj. Majers.

97. Lidhur me argumentin e ZPS-së se Aktekspertiza e Majersit dhe/ose dëshmia e znj. Majers nuk do ta ndihmonte Trupin Gjykses, pranohet se disa nga çështjet ligjore të trajtuara nga znj. Majers janë brenda njohurive të Trupi Gjykses dhe mund të zgjidhen pa ndihmën e një eksperti. Trupi Gjykses gjithashtu pajtohet me parashtrimin e ZPS-së se aspektet ligjore zakonisht nuk i nënshtrohen mendimit të ekspertit, përveç nëse ato lidhen me ligje të huaja ose ligje përtej ekspertizës së Trupit Gjykses.¹³¹ Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se ekspertja e propozuar ka njëfarë ekspertize të veçantë lidhur me këtë fushë të së drejtës dhe se ekspertiza e saj lidhur me të nuk kontestohet, dëshmia e propozuar e saj mund të jetë e vlefshme për Trupin Gjykses për të marrë vendimin e vet. Për më tepër, opinionin e znj. Majers mbi ato aspekte nuk është detyrues për Trupin Gjykses dhe ZPS-së do t'i jepet një mundësi e drejtë për të kundërshtuar ato aspekte të Aktekspertizës së Majersit me të cilat nuk pajtohet.

¹³⁰ *Shih më lart*, para. **Error! Reference source not found.**

¹³¹ *Për ngjashmëri*, ICTY/TPNJ, *Prokurori kundër Boshkoskit dhe Tarçulovskit*, IT-04-82-T, Trial Chamber, [Decision on Prosecution's 94 bis Notice re Expert Witness Sladjana Taseva](#), 8 February 2008, para. 8; *Prosecutor v. Stakic*, IT-97-24-A, Appeals Chamber, [Judgment](#), 22 March 2006, para. 164.

98. Lidhur me argumentet e ZPS-së se Aktekspertiza e Majersit dhe/ose dëshmia e znj. Majers do të uzurponte në mënyrë të papërshtatshme funksionet e Trupit Gjykses, Trupi Gjykses pajtohet pjesërisht me ato parashtrime. Aktekspertiza e Majersit përbëhet efektivisht nga dy elementë: (i) komente të përgjithshme lidhur me standardin ligjor që znj. Majers thotë se është i zbatueshëm dhe ka lidhje me një pretendim për "sinjalizim"; dhe (ii) pretendimet e znj. Majers lidhur me zbatimin e atij standard ligjor mbi ato që ajo i kupton se janë faktet e kësaj çështje. Ndërsa elementi i parë përfshihet në kuadrin e lejuar të opinionit të eksperti, nuk është kështu për elementin e dytë. Përkundrazi, komentet dhe përfundimet e znj. Majers lidhur me statusin e të akuzuarve si "sinjalizues", dhe përfundimet e saj lidhur me ligjshmërinë e sjelljes së tyre, janë plotësisht në kompetencën e Trupit Gjykses dhe përbëjnë uzurpim të funksioneve dhe përgjegjësiwe ekskluzive të Trupit Gjykses.¹³² Për këtë arsye, Trupi Gjykses nuk do t'i marrë parasysh paragrafët e mëposhtëm të Aktekspertizës së Majersit:

- a. paragrafët 23-25 (Pjesa IV);
- b. paragrafin 32 (Parimi 1; Pjesa V);
- c. paragrafin 34 (Parimi 2; Pjesa V), fjalia e dytë ("Sipas informacionit [...]") dhe fjalinë e fundit ("Të pandehurit [...]");
- d. paragrafin 36 (Pjesa V), fjalia e dytë ("Sipas mendimit tim [...]"); dhe
- e. paragrafin 40 (Përfundime).

99. Për të njëjtën arsye, palët urdhërohen të mos i bëjnë znj. Majers asnjë pyetje që do t'i kërkonte asaj të komentojë mbi provat e paraqitura në këtë proces, ose të komentojë për zbatueshmërinë e analizave të saj ligjore mbi faktet e çështjes aktuale.

¹³² Për ngjashmëri, ICTY, Prokurori kundër Millutinoviçit dhe të tjerëve, IT-05-87-T, [Decision on Prosecution Objections Pursuant to Rule 94 bis to Expert Evidence of Radovan Radinoviç](#), 5 October 2007, para. 4; SCSL, *Prosecutor v. Taylor*, 03-01-T, [Decision on Defence application to exclude the evidence of proposed Prosecution expert witness Corinne Dufka or, in the alternative, to limit its scope and on urgent Prosecution request for decision](#), 19 June 2008, paras 21-22.

100. Lidhur me argumentin e ZPS-së se Aktekspertiza e Majersit ishte përgatitur në baza të palejueshme, Trupi Gjykses vëren se kjo mund të trajtohet plotësisht dhe në mënyrë të duhur përmes marrjes në pyetje nga pala kundërshtare. Trupi Gjykses konstaton se, në rrethanat e kësaj çështjeje, kjo nuk do të ishte bazë e mjaftueshme për të refuzuar dëshminë e ekspertit të propozuar. Për më tepër, udhëzimi i Trupit Gjykses drejtuar palëve për të shmangur pyetjet që synojnë dhënien e përgjigjeve që uzurpojnë funksionet dhe përgjegjësitë ekskluzive të Trupit Gjykses duhet t'i japë përgjigje në mënyrë të kënaqshme këtij kundërshtimi.

101. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses rrëzon Kundërshtimin për Majersin dhe refuzon të përjashtojë dëshminë e DW1252-shit, përveç kufizimeve të përcaktuara në paragrafët 98-**Error! Reference source not found.**

4. Dëshmitari DW1253

(g) Parashtrimet e palëve

102. Mbrojtja e Haradinajt parashtron se DW1253 është një oficer policie me shumë përvojë nga Australia dhe ish-shef i Operacioneve në Zyrën e Prokurorit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë. Mbrojtja e Haradinajt parashtron më tej se ai është "ekspert i njohur me mbi tridhjetë (30) vjet përvojë në aspektet hetimore dhe ligjore të së drejtës penale dhe humanitare ndërkombëtare dhe, rrjedhimisht, i ka kualifikimet e duhura".¹³³ Sipas Mbrojtjes së Haradinajt, dëshmia e dëshmitarit DW1253 është bërë e nevojshme për shkak të dëshmisë gojore të dëshmitarit të ZPS-së W04841.¹³⁴ Mbrojtja e Haradinajt parashtron se W04841 dëshmoi lidhur me praktika dhe procedura të caktuara që ndiqen nga hetuesit dhe prokurorët e TFHS-së/ZPS-së, por nuk ishte në gjendje të jepte dëshmi ose të shprehej mbi përshtatshmërinë e

¹³³ Kërkesa e Haradinajt për Dëshmitar Ekspert Shtesë, para. 5.

¹³⁴ Kërkesa e Haradinajt për Dëshmitar Ekspert Shtesë, para. 12.

procedurave në këtë çështje.¹³⁵ Sipas Mbrojtjes së Haradinajt, “procedurat e ZPS-së, përshtatshmëria dhe besueshmëria e tyre në këtë çështje kanë të bëjnë me thelbin e argumenteve dhe provave të Prokurorisë dhe Mbrojtjes”.¹³⁶ Propozohet që DW1253-i të dëshmojë "drejtpërsëdrejti për standardet, praktikat dhe procedurat hetimore ndërkombëtare, përfshirë ato të përshkruara nga W04841, veçanërisht operacionet e kontrollimit dhe sekuestrimit dhe mbajtjen dhe sigurimin e materialit provues".¹³⁷ Gjithashtu, ose në alternativë, dëshmia e propozuar e ekspertit thuhet se është e nevojshme sepse:

- a. Informacioni lidhet drejtpërdrejt me disa argumente mbrojtëse që të akuzuarit kërkojnë të ngrenë në këtë çështje, përfshirë kundërshtimet ndaj kronologjisë së ruajtjes së provave nga ZPS-ja, verifikimin e autenticitetit të materialeve që konsiderohen konfidenciale dhe jopublike, dhe argumentin mbrojtës të shtytjes për kryerje të veprës penale, dhe, për rrjedhojë, shtimi dëshmisë së ekspertit është i nevojshëm në interes të drejtësisë;
- b. Informacioni mbi praktikat dhe procedurat e hetuesve dhe prokurorëve të TFHS-së/ZPS-së që do të zbulohet nga dëshmia e W04841-shit është informacion i ri dhe për këtë arsye kërkon përgjigje;
- c. DW1253 do të përgjigjet kryesisht në lidhje me faktet dhe aspektet e ngritura në dëshminë e W04841-it dhe, për rrjedhojë, kuadri i dëshmisë së ekspertit do të jetë i kufizuar; dhe
- d. Shtimi i dëshmisë së ekspertit nuk do të cenojë ZPS-në, sepse ajo do të ketë mundësinë t’i bëjë pyetje DW1253-shit dhe do të ketë kohë më se të mjaftueshme për t’u përgatitur.¹³⁸

¹³⁵ Kërkesa e Haradinajt për Dëshmitar Ekspert Shtesë, para. 13.

¹³⁶ Kërkesa e Haradinajt për Dëshmitar Ekspert Shtesë, para. 14.

¹³⁷ Kërkesa e Haradinajt për Dëshmitar Ekspert Shtesë, para. 15.

¹³⁸ Kërkesa e Haradinajt për Dëshmitar Ekspert Shtesë, para. 16.

103. Në Kundërshtimin për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, ZPS-ja konteston lidhjen me çështjen të të gjitha pjesëve të Aktekspertizës së Dëshmitarit të Dytë Ekspert të propozuar. Sipas ZPS-së, dëshmia e propozuar, që pretendohet se ka të bëjë me standardet hetimore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të lidhura me to, nuk kanë lidhje me akuzat kundër të akuzuarve.¹³⁹ ZPS-ja shton se edhe nëse Trupi Gjykses e konsideron lëndën e Aktekspertizës së Dëshmitarit të Dytë Ekspert si të lidhur me çështjen, ajo aktekspertizë trajton çështje juridike dhe faktike, vendimi për të cilat është tërësisht brenda kompetencës së Trupit Gjykses.¹⁴⁰ ZPS-ja më tej parashtron se nuk kërkohet që dëshmia e ekspertit t'i mundësojë avokatit mbrojtës të paraqesë parashtrime për këto aspekte, ose për të ndihmuar Trupin Gjykses gjatë shqyrtimit të tyre.¹⁴¹ Në vend që të ndihmojnë Trupin Gjykses, thuhet se provat e propozuara “do të rrezikonin të uzurponin në mënyrë të papërshtatshme funksionet e tij si gjykses i përfundimtar i aspekteve faktike dhe juridike”.¹⁴² ZPS-ja gjithashtu kritikon Aktekspertizën e Dëshmitarit të Dytë Ekspert lidhur me ato që sipas saj janë pretendime të pabazuara.¹⁴³

104. Në përgjigje, Mbrojtja e Haradinajt refuzon pretendimet e ZPS-së se dëshmia e propozuar nuk ka lidhje me akuzat kundër të akuzuarve dhe se Aktekspertiza e Dëshmitarit të Dytë Ekspert nuk do ta ndihmonte Trupin Gjykses dhe do të uzurponte në mënyrë të papërshtatshme funksionet e Trupit Gjykses.¹⁴⁴ Mbrojtja e Haradinajt argumenton se Aktekspertiza e Dëshmitarit të Dytë Ekspert dhe dëshmia e tij jo vetëm që është e besueshme, e rëndësishme dhe ndihmëse për Trupin Gjykses, por janë gjithashtu thelbësore për legjitimitetin dhe përshtatshmërinë e hetimeve të ZPS-së, të cilat Mbrojtja i konsideron aspekt të rëndësishëm.¹⁴⁵ Për rrjedhojë,

¹³⁹ Kundërshtimi për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, para. 2.

¹⁴⁰ Kundërshtimi për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, para. 2.

¹⁴¹ Kundërshtimi për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, para. 2.

¹⁴² Kundërshtimi për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, para. 2.

¹⁴³ Kundërshtimi për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, para. 3.

¹⁴⁴ Përgjigjja ndaj Kundërshtimit për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, para. 11-46.

¹⁴⁵ Përgjigjja ndaj Kundërshtimit për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, para. 20-22, 26, 30-33, 49.

Haradinaj parashtron se Kundërshtimi për Dëshmitarin e Dytë Ekspert duhet të refuzohet.¹⁴⁶

(h) Konstatimet e Trupit Gjykues

105. Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja dëshiron të thërrasë DW1253-shin për të dhënë një opinion për çështjet në vijim: (i) ligjshmërinë e operacioneve të kontrollimit dhe konfiskimit të kryera nga ZPS-ja; (ii) procesin e vërtetimit të autenticitetit të përdorur nga një dëshmitar i ZPS-së (W04841) për të përcaktuar karakterin konfidencial/jopublik të disa dokumenteve dhe besueshmërinë e tyre; dhe (iii) përshtatshmërinë dhe mjaftueshmërinë e “kronologjisë së mbajtjes në ruajtje” (përfshirë të inventarit) të përdorur nga ZPS-ja për materialin e marrë prej OVL-UÇK-së, sa i takon besueshmërisë dhe autenticitetit të materialit të marrë.

106. Trupi Gjykues thekson se DW1253 është pa dyshim hetues penal me përvojë dhe shumë i kualifikuar. Asnjëra palë nuk synon të kundërshtojë profesionalizmin e dëshmitarit dhe nuk ka asnjë dyshim që ai është dhe do të jetë i paanshëm lidhur me çështjet për të cilat do t'i kërkohet të dëshmojë.¹⁴⁷ Megjithatë, pyetja që Trupi Gjykues duhet ta trajtojë është nëse dëshmia e propozuar e tij përfshihet në kuadrin e asaj që është e lejueshme si “dëshmi eksperti”. Për arsyet e përshkruara më poshtë, Trupi Gjykues nuk është bindur se është kështu.

107. Së pari, dëshmia e propozuar lidhet me çështje të cilat Trupi Gjykues mund t'i përcaktojë vetë, pa ndihmën e dëshmisë së ekspertit.¹⁴⁸ Ato janë çështje juridike, faktike dhe të provave që palët i kanë ngritur si pjesë të provave të tyre. Për të dhënë

¹⁴⁶ Përgjigjja ndaj Kundërshtimit për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, para. 48.

¹⁴⁷ Për ngjashmëri, ICTR, *Prosecutor v. Akayesu*, ICTR-96-4-T, Trial Chamber, [Decision on a Defence Motion for the Appearance of an Accused as an Expert Witness](#), 9 March 1998.

¹⁴⁸ Për ngjashmëri, SCSL, *Prosecutor v. Taylor*, 03-01-T, Trial Chamber, [Decision on Defence application to exclude the evidence of proposed Prosecution expert witness Corinne Dufka or, in the alternative, to limit its scope and on urgent Prosecution request for decision](#), 19 June 2008, paras 18-20; ICTR, *Prosecutor v. Karemera et al.*, 98-44-T, Trial Chamber, [Decision on Prosecution Motion for Reconsideration of the Decision on Prospective Experts Guichaoua, Nowrojee and Des Forges, or for Certification](#), 16 November 2007, paras 13-14.

një opinion mbi këto, nuk duket se DW1253 mbështetet në ndonjë lloj ekspertize - për sa i përket njohurive ose përvojës - që Trupi Gjykses nuk e zotëron tashmë. Trupi Gjykses vëren lidhur me këtë se Mbrojtja nuk i ka cituar Trupit Gjykses ndonjë precedent ku është pranuar dëshmia e ekspertit në lidhje me natyrën e përgjithshme të fakteve dhe rrethanave të cilat Mbrojtja e Haradinajt propozon t'i shtjellojë përmes dëshmitarit DW1253.

108. Së dyti, dëshmia e propozuar e DW1253-shit do të uzurponte, në disa aspekte, përgjegjësitë e Trupit Gjykses. Në veçanti, Trupi Gjykses vëren se çështjet për të cilat do t'i kërkohet atij të dëshmojë përfshihen plotësisht në përgjegjësinë e Trupit Gjykses, sepse do të çonin në dhënien e dëshmimeve në lidhje me peshën, besueshmërinë ose pranueshmërinë e provave që tashmë janë pjesë e dokumentacionit të çështjes. Mbrojtja synon gjithashtu t'i kërkojë DW1253-shit të japë mendimin e tij mbi vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e operacioneve të kontrollimit dhe sekuestrimit të kryera nga ZPS-ja, që janë çështje brenda fushës së përgjegjësisë së Trupit Gjykses. Trupi Gjykses vëren lidhur me këtë se DW1253 propozon të japë opinionin e tij jo vetëm për pajtueshmërinë e operacioneve të kontrollimit dhe sekuestrimit me ato që ai i cilëson si "standardet më të larta, dhe praktikrat dhe procedurat më të mira ndërkombëtare të hetimit", por edhe me Rregulloren.¹⁴⁹ Kjo është përgjegjësi e Trupit Gjykses dhe nuk mund t'i nënshtrohet opinionit të ekspertit.

109. Së treti, Trupi Gjykses vëren se DW1253 nuk pretendon të ketë kryer një shqyrtim të ngjashëm me atë që W04841 tha se ka kryer për vërtetimin dhe verifikimin e statusit konfidencial të materialit të kundërshtuar. Për rrjedhojë, DW1253 nuk ka ekspertizë të demonstruar që i mundëson të japë opinion si ekspert për atë pikë. Edhe nëse ka një opinion, ai opinion nuk do t'i shtonte vlerë asaj që Trupi Gjykses mund ta përcaktojë bazuar në njohuritë dhe përvojën e vet. Për më tepër, sa i takon përpjekjes

¹⁴⁹ *Shih* Aktekspertiza e Dëshmitarit të Dytë Ekspert, para. 26-27, 30-31.

së Mbrojtjes për të kundërshtuar metodën e përdorur nga W04841 për atë qëllim, Mbrojtja i paraqiti kundërshtimet e saj kur e mori në pyetje atë dëshmitar.¹⁵⁰

110. Së fundi, Trupi Gjykses vëren se pjesa më e madhe e asaj që propozon të thotë DW1253 mund të paraqitet nga mbrojtësit në trajtën e parashtrimeve.¹⁵¹ Kjo në veçanti, sa u përket "praktikave më të mira" lidhur me të cilat DW1253 ka theksuar se mund të jenë të rëndësishme dhe të cilat mund të paraqiten nga Mbrojtja si pjesë e dosjeve gjyqësore përfundimtare dhe deklaratave përmbyllëse.

111. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses miraton Kundërshtimin për Dëshmitarin e Dytë Ekspert dhe refuzon të dëgjojë dëshminë e DW1253-shit.

E. DËSHMITË E PROPOZUARA TË DËSHMITARËVE DW1243, DW1244, DW1245, DW1247, DW1248 DHE DW1254

5. Parashtrimet e palëve

112. Në Kërkesën Shtesë të saj, ZPS-ja i kërkon Trupit Gjykses që: (i) të mos autorizojë dëshminë e dëshmitarit DW1248 të Mbrojtjes së Gucatit ("kërkesa e parë shtesë"); dhe (ii) të mos autorizojë dëshmi të palejueshme që konsistojnë në dhënien e opinioneve që nuk kanë lidhje me akuzat, përfshirë ato që përmbahen në deklaratat e pesë dëshmitarëve të propozuar (DW1243, DW1244, DW1245, DW1247, DW1254) ("kërkesa e dytë shtesë").¹⁵²

113. Lidhur me kërkesën e parë shtesë, Mbrojtja e Gucatit përgjigjet se, meqenëse ZPS-ja nuk e kundërshton faktin që artikujt e kundërshtuar janë ende të disponueshëm publikisht në internet - që është qëllimi i vetëm i deklaratës dhe

¹⁵⁰ Shih në përgjithësi, F00427, Trupi Gjykses, *Vendimi mbi Pranueshmërinë e Proovave Materiale të Shtyra dhe Klasifikimin e Disa Proovave Materiale të Pranuara*, 9 nëntor 2021, para. 8.

¹⁵¹ Për ngjashmëri, ICTR, *Prosecutor v. Nahimana et al.*, 99-52-A, Appeals Chamber, [Decision on the Expert Witnesses for the Defence](#), 24 January 2003, paras 21-22; *Prosecutor v. Nahimana et al.*, 99-52-A, Appeals Chamber, [Appeal Judgement](#), 28 November 2007, paras 293-294.

¹⁵² Shih në përgjithësi Kërkesa Shtesë.

dëshmisë së propozuar të DW1248-ës - Mbrojtja e Gucatit propozon që ky aspekt të konsiderohet si fakt për të cilin palët pajtohen.¹⁵³ Në përgjigje, ZPS-ja vazhdon të jetë e mendimit se dëshmia e propozuar nuk lidhet me çështjen, por se, në qoftë se Trupi Gjykses vendos ndryshe, ZPS-ja ofron që deklarata e DW1248-ës të pranohet përmes rregullës 153 të Rregullores ose, në alternativë, të trajtohet si një fakt për të cilin palët pajtohen.¹⁵⁴

114. Lidhur me kërkesën e dytë shtesë, Mbrojtja e Gucatit përgjigjet se nuk ka nevojë për një "qëmtim të imtësishëm" të lidhjes me çështjen të secilës fjali në deklaratat e dëshmitarëve, sepse dëshmitarët do të thirren dhe do të pyeten nga pala kundërshtare dhe sepse Trupi Gjykses do të përcaktojë peshën e duhur që do t'u jepet deklaratave (ose pjesëve të tyre) në kohën e duhur.¹⁵⁵ ZPS-ja përgjigjet se rregulla 154 e Rregullores nuk duhet të përdoret për të anashkaluar rregullën 138 të Rregullores. ZPS-ja parashtron se disa pjesë të deklaratave me shkrim nuk kanë lidhje me çështjen dhe kundërshton pranimin e tyre sipas rregullës 154, duke vërejtur se, në qoftë se një dëshmi e tillë do të jepej *viva voce*, ZPS-ja do ta konsideronte atë si të papranueshme dhe njësoj do ta kundërshtonte atë.¹⁵⁶

2. Konstatimet e Trupit Gjykses

115. Trupi Gjykses vëren se dëshmia dhe deklarata e propozuar e DW1248-ës lidhet me disponueshmërinë në internet të një numri artikujsh në kohën kur DW1248 bëri deklaratën e tij me shkrim. Nga parashtrimet e palëve duket se nuk ka asnjë mospajtim lidhur me disponueshmërinë e artikujve të kundërshtuar në internet në kohën kur DW1248-a bëri deklaratën e tij.¹⁵⁷ Për rrjedhojë, Trupi Gjykses mund ta marrë parasysh atë fakt sikurse janë pajtuar palët, pa qenë nevoja të thërrasë DW1248-ën.

¹⁵³ Versioni jopërfundimtar i transkriptit, 2 dhjetor 2021, f. 2071-2072.

¹⁵⁴ Versioni jopërfundimtar i transkriptit, 2 dhjetor 2021, f. 2076.

¹⁵⁵ Versioni jopërfundimtar i transkriptit, 2 dhjetor 2021, f. 2071.

¹⁵⁶ Versioni jopërfundimtar i transkriptit, 2 dhjetor 2021, f. 2071.

¹⁵⁷ Kërkesa Shtesë, para. 4.

Megjithatë, nëse Mbrojtja dëshiron ta paraqesë deklaratën e DW1248-ës si provë, ajo mund të bëjë kërkesën për pranim në përputhje me rregullën 153 të Rregullores, siç sugjerohet nga ZPS-ja.¹⁵⁸

116. Lidhur me kërkesën e dytë shtesë, Trupi Gjykues pajtohet me parashtrimin e ZPS-së se gjykimi nuk është vendi ku dëshmitarët të bëjnë hamendje ose të japin opinione që nuk kanë bazë faktike.¹⁵⁹ Megjithatë, zbatimi i këtij parimi nga Trupi Gjykues kërkon njëfarë kujdesi. Dëshmitarët mund të japin dëshmi në formën e opinioneve që janë të rëndësishme për përcaktimin e së vërtetës, veçanërisht kur dëshmitari ofron faktet ku e mbështet atë opinion, dhe kur opinionin mbështetet nga prova të tjera. Provat e tjera mund të jenë pjesërisht të bazuara në fakte dhe pjesërisht të bazuara në opinione. Kjo sugjeron që palët duhet të kenë *njëfarë* diskrecioni kur paraqesin dëshmi që japin opinione, si dhe faktet ku mbështeten ato opinione, dhe Trupi Gjykues duhet të matet përpara se të mos lejojë marrjen në pyetje të një dëshmitari lidhur me opinionin e tij/saj.

117. Trupi Gjykues pajtohet me ZPS-në se disa nga pohimet e përfshira në deklaratat e dëshmitarëve të propozuar përbëjnë opinione, dhe se disa nga këto opinione duket se janë pak ose aspak të bazuara në fakte.¹⁶⁰ Megjithatë, në këtë fazë, këto deklarata nuk janë paraqitur si prova dhe Mbrojtja nuk ka kërkuar t'i marrë këto opinione nga dëshmitarët e saj të mundshëm. Nëse dhe kur Mbrojtja të kërkojë ta bëjë këtë, ZPS-ja mund të kundërshtojë marrjen e këtyre opinioneve ose pranimin e një deklarate të propozuar, mbi atë bazë. Gjithashtu, ose në alternativë, ZPS-ja mund të zgjedhë t'i trajtojë këto çështje kur t'i marrë në pyetje ata dëshmitarë.

118. Megjithatë, Trupi Gjykues përsërit urdhrin e tij që palët nuk duhet të kërkojnë nga dëshmitarët dëshmi që nuk lidhen me çështjen. Në veçanti, Trupi Gjykues tashmë

¹⁵⁸ Kërkesa Shtesë, para. 5.

¹⁵⁹ Kërkesa Shtesë, para. 2.

¹⁶⁰ Kërkesa Shtesë, para. 7-8.

ka theksuar se “drejtësia” e luftës, apo prova që kanë të bëjnë me krimet e kryera nga cilado palë gjatë konfliktit në Kosovë nuk janë aspekte që lidhen me këtë çështje.¹⁶¹ Trupi Gjykses gjithashtu thekson se dëshmitë që janë opinione të dhëna nga një dëshmitar që nuk është ekspert, ose që nuk mund të paraqesë ndonjë fakt në mbështetje të opinionit të tij/saj, do të ketë pak peshë, edhe nëse Trupi Gjykses lejon dhënien e atyre dëshmimeve.

119. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses e rrëzon kërkesën e dytë shtesë si të parakohshme dhe nuk pranon të përjashtojë, në këtë moment, pjesë të dëshmisë dhe provave të pritshme të dëshmitarëve DW1243, DW1244, DW1245, DW1247 dhe DW1254.

V. LEJE PËR APELIM

120. Trupi Gjykses vëren që në fillim se vendimi nëse do të kërkohet leje për apelim sipas rregullës 77 të Rregullores i takon palës përkatëse. Pala në fjalë duhet të vlerësojë aspektet juridike dhe praktike, nëse do të bëjë kërkesë për leje për apelim. Në rastin konkret, Trupi Gjykses është i mendimit se, nëse Mbrojtja e Haradinajt kërkon leje për apel sipas rregullës 77 të Rregullores, Trupi Gjykses do të prirej t’ia jepte lejen në lidhje me aspektet e mëposhtme që dalin nga ky vendim:

- a. Konstatimet e Trupit Gjykses se dëshmitë e propozuara të DW1250-ës dhe DW1251-it nuk lidhen me çështjen dhe vendimin e tij për të mos dëgjuar dëshmitë e këtyre dëshmitarëve; dhe
- b. Konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me karakterin e palejueshëm të dëshmisë së propozuar të DW1253-shit sipas rregullës 149 të Rregullores dhe vendimit të tij për të mos dëgjuar dëshminë e këtij dëshmitari.

¹⁶¹ Urdhër gojor lidhur me kujtesën e ekipeve mbrojtëse për marrjen në pyetje të dëshmitarëve, Versioni jopërfundimtar i transkriptit, 2 dhjetor 2021, f. 2109-2110.

121. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Haradinajt që, deri më 6 dhjetor 2021, të bëjë të ditur nëse synon të kërkojë leje për apelimin e ndonjërit prej aspekteve të lartpërmendura. Mbrojtjes së Haradinajt nuk i kërkohet të bëjë parashtrime lidhur me standardin e miratimit sipas rregullës 77(2) të Rregullores në lidhje me aspektet e lartpërmendura.

122. Nëse Mbrojtja e Haradinajt dëshiron të kërkojë leje për apelim për aspekte të tjera që dalin nga ky vendim, Trupi Gjykses urdhëron që kjo të bëhet në të njëjtin parashtrim dhe brenda të njëjtit afati. Për këto parashtrime, Mbrojtja e Haradinajt duhet të paraqesë argumente në përputhje me standardin e miratimit sipas rregullës 77(2) të Rregullores.

123. Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në që të përgjigjet deri më 8 dhjetor 2021. Trupi Gjykses nuk do të pranojë kundërpërgjigje.

VI. KLASIFIKIMI

124. Lidhur me Kërkesën për Heqje nga Lista (F00312), Përgjigjet (F00329; F00330), Kundërshtimin për Dëshmitarin e Dytë Ekspert (F00438), Përgjigjen ndaj Kundërshtimit për Dëshmitarin e Dytë Ekspert (F00444) dhe Kërkesën Shtesë (F0046), Trupi Gjykses vëren se parashtrimet nuk përmbajnë informacion identifikues të dëshmitarëve dhe/ose ekspertëve të kundërshtuar. Trupi Gjykses vëren më tej se, përveç Përgjigjes ndaj Kundërshtimit për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, ku nuk përmendet çështja e riklasifikimit, në rastet e tjera pala parashtruese shprehimisht deklaroi se nuk e kundërshton riklasifikimin e parashtrimeve të protokolluara.¹⁶² Për rrjedhojë, Trupi Gjykses do të urdhërojë riklasifikimin si publik të parashtrimeve F00312, F00329, F00330, F00438, F00444 dhe F00466 në përputhje me rregullën 82(5) të Rregullores.

¹⁶² Kërkesa për Heqje nga Lista, para. 22; Përgjigjja e Gucatit, para. 60; Përgjigjja e Haradinajt, para. 49; Kundërshtimi për Dëshmitarin e Dytë Ekspert, para. 18; Kërkesa Shtesë, para. 10.

125. Lidhur me Parashtrimet Paraprake lidhur me Dëshmitarët e Haradinajt (F00289) dhe Kërkesën e Haradinajt për Dëshmitar Ekspert Shtesë (F00394), Trupi Gjykses vëren se ato përmbajnë informacione identifikuese të dëshmitarëve të tërhequr dhe/ose të kundërshtuar. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se Lista e Dëshmitarëve të Propozuar të Haradinajt (F00461/A01) është parashtruar me klasifikimin publik, por përmban emrat e dëshmitarëve të kundërshtuar. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses udhëzon Mbrojtjen e Haradinajt që të dorëzojë versionet e redaktuara publike të këtyre parashtrimeve ose të kërkojë riklasifikimin e tyre si publike.

126. Lidhur me udhëzimet për znj. Majers (F00386/A01), Trupi Gjykses udhëzon Mbrojtjen e Haradinajt që të dorëzojë versionet e redaktuara publike të këtyre parashtrimeve, ose të kërkojë riklasifikimin e tyre si publike.

VII. VENDIM

127. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **RRËZON** pjesërisht kërkesën e parë dhe refuzon të përjashtojë dëshminë e DW1246-ës;
- b. **MIRATON** pjesërisht kërkesën e parë dhe refuzon të dëgjojë dëshmitë e DW1250-ës dhe DW1251-it;
- c. **RRËZON** kërkesën e dytë si të parakohshme dhe refuzon të përjashtojë, në këtë moment, pjesë të dëshmisë së pritshme të DW1241-it dhe DW1242-it;
- d. **RRËZON** Kundërshtimin për Majersin dhe refuzon të përjashtojë dëshminë e DW1252-it, me kufizimet e përcaktuara në paragrafët 98-**Error! Reference source not found.**;
- e. **MIRATON** Kundërshtimin për Dëshmitarin e Dytë Ekspert dhe refuzon të dëgjojë dëshminë e DW1253-shit;

- f. **UDHËZON** Mbrojtjen e Gucatit që të informojë Trupin Gjykes deri më **10 dhjetor 2021** nëse Trupi Gjykes mund të marrë parasysh një fakt të pranuar nga palët lidhur me DW1248-ën ose nëse Mbrojtja e Gucatit synon të paraqesë deklaratën e DW1248-ës për pranim në përputhje me rregullën 153 të Rregullores;
- g. **RRËZON** kërkesën e dytë shtesë si të parakohshme dhe refuzon të përjashtojë, në këtë moment, pjesë të dëshmisë dhe provave të pritshme të dëshmitarëve DW1243, DW1244, DW1245, DW1247, DW1254;
- h. **URDHËRON** Mbrojtjen e Haradinajt që, deri më **6 dhjetor 2021**, të bëjë të ditur nëse synon të kërkojë leje për apelim në përputhje me paragrafët **Error! Reference source not found.-Error! Reference source not found.** dhe/ose të parashtrojë kërkesa të mëtejshme për miratim, në përputhje me paragrafin **Error! Reference source not found.**; dhe
- i. **URDHËRON** ZPS-në që, deri më **8 dhjetor 2021**, t'i përgjigjet çdo kërkesë të lartpërmendur për leje për apelim;
- j. **UDHËZON** administratoren të riklasifikojë si publike parashtrimet F00312, F00329, F00330, F00438, F00444 dhe F00466; dhe
- k. **URDHËRON** Mbrojtjen e Haradinajt të dorëzojë deri më **10 dhjetor 2021**, versionin e redaktuar publik të parashtrimeve F00289, F00386/A01 dhe F00394 ose të kërkojë riklasifikimin e tyre si publike.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 3 dhjetor 2021

Në Hagë, Holandë